



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 14:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 11. Emona Muçi | (anëtare) |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)*
- 6. Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtim i projektvendimit “Mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Përsëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni sot nga ana e Këshillit do merren në shqyrtim 9 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja juaj.

Pa humbur kohë po fillojmë me çështjen e parë e cila ka të bëjë me miratimin e rregullave “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil”. Me këtë akt, le të themi, përmbyllen të gjithë aktet të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e karrierës, me administrimin e nëpunësit civil gjyqësor nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Akti propozohet nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe do relatohet në mbledhjen plenare nga drejtoresha e Departamentit të Burimeve Njerëzore, znj. Etrita. Shkurtimeisht prezantimin e aktit.

Etrita Petriti: Të nderuar, faleminderit!

Akti që paraqitet për miratim Këshillit është një akt nënligjor i cili është në përputhje me parimet mbi të cilat mbështetet shërbimi civil gjyqësor, veçanërisht me detyrimin që buron nga kuadri ligjor për përcaktimin e rregullave më të detajuara lidhur me procedurat e pezullimit nga shërbimi civil gjyqësor për kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë, si dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor. Për arritjen e këtij objekti, rregullorja e paraqitur për miratimin trajton organet/ procedurat/ afatet/ kushtet mbi pezullimin apo ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor, për kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë: (i) Kancelar, Këshilltar Ligjor dhe Ndihmës Ligjor, dhe (ii) nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë.

Akti i konceptuar është një tërësi rregullash dhe ka për qëllim plotësimin e bazës ligjore për mirëfunksionimin e administratës së gjykatës, për përgjegjësitë e nëpunësve civilë gjyqësorë mbi veprimtarinë e tyre funksionale.

Rregullorja përbëhet nga tre seksione të ndara në krerë respektive dhe nga 23 nene të cilat janë të detajuara në relacionin e paraqitur.

Pra trajtohet objekti i rregullores; Kuptimi i termave referuese të rregullores; Përcaktohen rastet e pezullimit nga shërbimi civil gjyqësor; Shkaqet e pezullimit; Organi kompetent për deklarimin e tij; si dhe efektet; dhe është i organizuar në gjashtë nene.

Gjithashtu në aktin e paraqitur përcaktohet procedura, afatet, organet kompetente, statusi i nëpunësit civil gjyqësor lidhur me pozicionet e punës në momentin e përfundimit të pezullimit dhe është i organizuar në dy nene.

Në seksionin e dytë përcaktohen rastet e ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor, shkaqet, organet kompetente, si dhe vendimmarrja.

Rregullorja do të vihet në zbatim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, këshillat e gjykatave respektive, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu në projektvendim përcaktohet miratimi i rregullores për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor sipas vendimit bashkëlidhur. Do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim nga kolegët?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Miratimin e Rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Yllka Rupa.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 14:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
2. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Yllka Rupa.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e dytë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën 2013-2016”.

Për më shumë detaje fjalën ia jap relatores znj. Yllka Rupa.
Në këtë proces nuk do jetë z. Markelian, në shqyrtimin e këtij projekt-akti.

Yllka Rupa: Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren {...} ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtares e cila ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë.

Raporti përmban të plotë procedurën e ndjekur, kështu që do të relatoj në lidhje me rezultatet e vlerësimit për gjithsecilin nga katër kriteret e vlerësimit, duke filluar me “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, “Njohuritë Ligjore”, 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave. Bazuar në të dhënat e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të

saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre duke i ndërthurur në çdo rast me provat e administruara në gjykim. Gjithashtu evidentohen aftësi shumë e mirë në identifikimin e normave konkrete procedurale dhe materiale të akteve ligjore dhe nënligjore, që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi. Propozohet vlerësimi i saj lidhur me këtë tregues shumë i lartë, pikëzimi 25 pikë.

Lidhur me 1.A.b Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, në tërësi rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuar, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Lidhur me “Arsyetimin ligjor”, për sa i takon 1.B.a Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit, në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Gjithashtu gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit të shprehur, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime logjike nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në shërbim të argumentimit të çështjeve të ngritura prej saj për zgjidhje, apo zgjidhjen tërësore të çështjes. Propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 15.

Lidhur me 1.B.b Strukturën e qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, bazuar në të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe të përmbajtjes. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 10.

Lidhur me 1.B.c Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, referuar të dhënave, gjithashtu rezulton të ketë performancë shumë të mirë edhe në këtë tregues gjyqtarja, kështu që propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Lidhur me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarës” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Lidhur me “Aftësitë organizative të gjyqtarës”, për sa i takon 2.A.a Respektimit të afateve ligjore, referuar të dhënave në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore”

gjqtarja duhet të vlerësohet dhe të pikëzohet me 15 pikë, pasi mbështetur në burimet e vlerësimit nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor dhe ka respektuar në çdo rast afatet procedurale të parashikuar në ligj për kryerjen e veprimeve të caktuara.

Për sa i takon 2.A.b Plotësimi të standardit minimal kohor, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me këtë tregues, në raport edhe me çështjet e gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuara, rezulton ky raport në masën 7,1% dhe bazuar në përcaktimet e metodologjisë, gjyqtarja duhet të vlerësohet në nivelin maksimal lidhur me këtë tregues.

Për sa i takon 2.A.c Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, mbështetur në analizën e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka një performancë shumë të mirë edhe lidhur me këtë tregues prandaj propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë.

Ka rezultuar që koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha çështjet e marra në analizë.

Për sa i takon 2.A.ç Rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rendimenti është në përqindjen 92,1% dhe referuar metodologjisë së pikëzimit pikëzohet me 6 pikë. Por duke pas parasysh faktin se në çdo vit ajo ka tejkaluar standardin minimal të ngarkesës në punë mesatarisht në 214% në çdo vit, vlerësohet dhe propozohet niveli maksimal i vlerësimit lidhur me këtë tregues.

Për sa i takon 2.A.d Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, rezulton që koha mesatare e arsyetimit të vendimit për të gjitha kategoritë e çështjeve të jetë 7,9 ditë. Duke marrë në konsideratë një tejkalim të papërfillshëm, propozohet niveli i vlerësimit me 15 pikë lidhur me këtë tregues.

Në lidhje me 2.B Aftësinë e gjyqtarës për të kryer procedurat gjyqësore, 2.B.a.

Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive, rezulton që numri mesatar i seancave gjyqësore duke iu referuar 11 çështjeve të vëzhguara është 2,2 seanca, kështu që propozohet lidhur me këtë tregues pikëzimi me 15 pikë.

Po ashtu edhe 2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të mirë aftësie lidhur me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit me 20 pikë.

“Aftësia për të administruar dosjen gjyqësore”, në të dy komponentët 2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes dhe 2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Propozohet niveli i pikëzimit me 5 pikë lidhur me komponentin rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes dhe gjithashtu në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes propozohet niveli 10 pikë i vlerësimit pasi në tërësi dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë, është i plotë dhe nuk konstatohen mungesa aktesh dhe dokumentacione të tjera që nuk i përkasin çështjeve konkrete.

Kështu që lidhur me kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarës”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Lidhur me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, “Etika në punë”, 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion, duke iu referuar burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton që gjyqtarja ka angazhim dhe përgjegjshmëri të lartë në funksion. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë. Pikët 40.

Nuk përdor gjuhë diskriminuese gjatë ushtrimit të detyrës. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 10.

Lidhur me 3.C.b Numrin tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, për këtë arsye, për këtë tregues propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë.

Kështu që në lidhje me vlerësimin e kriterit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Lidhur me “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, është kriteri i fundit, mbi bazën e disa treguesve vlerësohet ky kriter, duke filluar me “Aftësinë e komunikimit”, 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent. Në tërësi referuar të dhënave, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim

si dhe në gjuhën e përdorur në përpilimin e akteve procedurale. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Lidhur me 4.A.b Respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për pasojë prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit si dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Propozohet niveli i vlerësimit i lartë, pikët 15.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, në aspektin e 4.B.a Shkalla e bashkëpunimit dhe komunikimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta, propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 15.

Ashtu edhe në aspektin e 4.B.b Shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 10.

“Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, 4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të shkollës së magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale, ka rezultuar se gjyqtarja të ketë marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues në 11 aktivitete trajnuese të zhvilluara në 15 ditë, kryesisht në fushën e të drejtës administrative dhe gjyqimit të marrëveshjeve administrative. Propozohet niveli i pikëzimit me 20 pikë.

Lidhur me 4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, lidhur me këtë tregues, në momentin e hartimit të projektraportit të vlerësimit gjyqtarja nuk ka paraqitur akte që provojnë kontributin lidhur me këtë tregues, kështu që është vlerësuar me 3 pikë, ndërkohë përmes kundërshtimeve dhe plotësimeve të akteve/ të dokumentacionit që përbën burim vlerësimi dhe analizohet në aspektin e pikëzimit të këtij treguesi, gjyqtarja paraqet një vërtetim të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, vërtetim: “...në bazë të të cilit vërtetojmë që znj. {...} është miratuar me vendim të Bordit të Shkollës së Magjistraturës si eksperte pranë formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për programin tematik të aktiviteteve trajnuese 2012-2016.

Lidhur me këtë vërtetim, me këtë akt, mendoj që përbën provë, mbi bazën e të

cilit, pra gjyqtarja duhet të rritet me 2 pikë. Kështu që unë propozoj rritjen me 2 pikë lidhur me këtë tregues për gjyqtaren {...}.

Për të kaluar tek 4.C.c Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari të tjera për marrëdhëniet me publikun në gjykata. Edhe lidhur me këtë tregues gjyqtarja është vlerësuar fillimisht me 3 pikë për shkak të mungesës së dokumentacionit që provon angazhim të tillë. Kështu që gjyqtarja ka paraqitur një vërtetim nga Kuvendi i Shqipërisë përmbajtja e të cilit konsiston në një kontribut të dhënë nga magistratja në kuadër të reformës në drejtësi dhe kjo shkresë është shoqëruar edhe me e-maillet dhe korrespondencën që gjyqtarja kishte me këtë organ. Kështu që propozoj rritjen e pikëve në këtë tregues, nga 3 në 5 pikë.

Lidhur me 4.C.ç Publikimet ligjore akademike, nuk rezultojnë publikime të tilla, kështu që propozohet niveli i vlerësimit me 0 pikë.

Në lidhje me nivelin e vlerësimit të këtij kriteri, pra “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, propozoj nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 95 për gjyqtaren {...}.

Në mënyrë të përmbledhur, propozimi për nivelin e pikëzimit dhe të vlerësimit për gjithsecilin nga katër kriteret e vlerësimit është si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarës, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë organizative, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, pikët 95, vlerësimi "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit propozohet të jetë pikët 395, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Atëherë, nga vetë relatorja janë propozuar rritja për dy indikatorët nga 2 pikë, pra 4 pikë. Pra në total nga relatorja propozohet që nga 391, të shkojë në 395, pa ndryshuar nivelin e gradimit.

Kemi ndonjë diskutim ose ndonjë propozim tjetër.

Nëse jo, atëherë e hedhim në tërësi raportin, së bashku me propozimet e bëra nga relatorja.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord me vlerësimin dhe me propozimet e reja që bëri relatorja në mbledhjen e sotme. Faleminderit!

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si me nivelin e përgjithshëm të vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, 395 pikë.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.79 datë 20.02.2024, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 14:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 5 sipas rendit të ditës.

9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.79 datë 20.02.2024, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, për të vijuar me rendin e ditës, kisha një propozim, që pikën 3 e cila ka të bëjë me hedhje shorti, ta lëmë në fund, bashkë me pikën 8, me qëllim që kur të thërrasim administratën për hedhjen e shortit, të jetë në vijimësi, bashkë me pikën 9. Kështu që do të propozoja në kalimin në pikën 5, 6 dhe 7 dhe më pas të kalohet tek pika 4, pika 3 dhe pika 8, me idenë që të menaxhojmë kohën.

Kështu që tek pika 5, zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Atëherë, pa humbur kohë, në mënyrë të përmbledhur po prezantojmë përpara Këshillit projektvendimin për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur në fushën e të drejtës civile. Ky pozicion është shpallur me vendimin nr. 79, datë 20.02.2024 për kandidaten znj. {...}.

Me vendimin nr.73 - nr.86 datë 20.02.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 73-81 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shtatë pozicione të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për dy pozicione të lirë në fushën e të drejtës penale. Me vendimet nr. 82-86 të vitit 2024 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për tre pozicione të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për dy pozicione të lirë në fushën e të drejtës penale.

Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë sipas nenit 43 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, afati përfundonte më datë 01.03.2024.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit nr.79/2024, 80/2024 dhe 81/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.127/2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura më lart.

Me vendimin nr. 140/2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73 – nr. 86/2024”, Këshilli vendosi:

Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore për pozicionet e përmendura më lart. Për kandidaten znj. {...} - relator u caktua z. Alban Toro.

Në përfundim të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore për kandidaten znj. {...}, Këshilli, me vendimin nr. 192/2024, vendosi:

Kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e shpallura me vendimet nr.79, nr. 80 dhe nr. 81, të vitit 2024.

Ndërkohë, me vendim nr. 205/2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat “c” dhe “ë”, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 7, 8 dhe 9 të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016, si dhe në pikën 75, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 320/2020, Këshilli vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë për pozicionet e shpallura përkatësisht me vendimet e përmendura më lart. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 22/2023, nr. 77, nr.86, nr.74, nr. 82, nr. 79, të vitit 2024, nr. 23/2023 u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës z. Klodian Kurushi.

Më datë 14.05.2024 kandidatja znj. {...}, me shkresën e përcjellë dhe të protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., të vitit 2024 paraqiti kërkesën për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 79/2024,. Ndër të tjera, në shkresën e saj kandidatja parashtroi se: Duke vlerësuar se plotësoja kriteret ligjore të parashikuara në nenet 8 pika 3; 43, pika 2, shkronja a) dhe c) dhe pika 6 të ligjit nr.96/2016, me shkresën datë 28.02.2024 kam paraqitur pranë Jush kërkesën për lëvizje paralele, për të ushtruar funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e të drejtës civile, për pozicionin e lire të shpallur me vendimin nr.79/2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me anë të kësaj kërkesë ju informoj se heq dorë nga kërkesa për lëvizje paralele për këtë pozicion, pra për pozicionin 79, datë 20.02.2024.

Në këto rrethana përgatitet ky relacion i cili i dërgohet dhe i propozohet Këshillit për t’u miratuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit z. Kurushi!

Atëherë, nëse s’kemi diskutime, kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti me propozimin e Komisionit.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 14:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6 sipas rendit të ditës.

- 9. Markelian Koça** (anëtar)
10. Yllka Rupa (anëtare)
11. Emona Muçi (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)**
- 5. Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë tek projekt-akti i dytë që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239/2023, për kandidaten znj. {...}. Relator është z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Znj. {...} është candidate për një pozicion në Gjykatën e Apelit Tiranë në fushën e të drejtës civile të hapur me vendimin nr. 239, 24.05.2023. Për këtë candidate janë kryer disa veprime procedurale të cilat nuk po i citoj për efekt të kohës. Gjithsesi mbas kryerjes së disa veprimeve procedurale në lidhje me të, nga ana e kësaj të fundit, nëpërmjet

19

shkresës 14.05.2024 protokolluar me 2628 protokolli ynë, është paraqitur një kërkesë për heqjen dorë duke parashtruar ndër të tjera se: Me anë të vendimin nr. 239, datë 24.05.2023 Këshilli ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, pozicion për të cilin unë kam shprehur interes si dhe duke u bazuar në pikën 6 të nenit 48 të Ligjit nr.96/2016, në kushtet kur shpreh interes për pozicionin e lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda nr. 247, datë 02.05.2024, paraqes kërkesën time për miratimin e dorëheqjes nga kandidimi për pozicioni sipas vendimit nr. 239 datë 24.05.2023.

Në kushtet kur ky veprim procedural është i parashikuar edhe në aktet tona nënligjore, dhe është një nga format e përfundimit të procedurës pa një vendim përfundimtar, në këto kushte nga ana e relatorit është përpiluar projektvendimi, në dizpozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni si më poshtë:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatori.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 14:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 7 sipas rendit të ditës.

9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}. Për më shumë detaje, fjalën e ka z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Me vendimin nr. 244, datë 24.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me seli në Tiranë, në fushën e të drejtës civile.

Në këtë procedurë të ngritjes në detyrë, afati i kandidimit u përcaktua deri më datë 14.06.2023.

Brenda afatit të kandidimit ka aplikuar dhe ka shprehur interesin e saj zonja {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me vendimin nr. 57/2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira të shpallura në fushën e të drejtës civile me vendimet e përmendura nr. 239, e vijues, Këshilli ndër të tjera vendosi:

Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë [...]. Caktimin e relatorit si më poshtë: Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi.

Brenda afatit të përcaktuar, pas fillimit të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore, kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit të saj si dhe për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht të gjithë dokumentacionin si dhe dorëzoi jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, deklaratën e pasurisë, duke plotësuar formularin përkatës sipas ligjit dhe vendimit nr. 79/2019.

Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidaten znj. {...} në lidhje me kriteret formale, Këshilli, me vendimin nr. 111, datë 06.03.2024, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimin nga kandidatja, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 244 datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore që kërkon pozicioni i ngritjes në detyrë.

Më tej, pra në vijim të procedurës së dytë të verifikimit të kriterëve ligjore, kandidatja më datë 15.05.2024 paraqiti një kërkesë protokolluar në Këshill me nr. 2668 prot., nga përmbajtja e të cilës rezulton se: “Unë, {...} (Nuni) ushtroj funksionin e magjistratit gjyqtar që nga viti 2004 e në vijim. Aktualisht, jam gjyqtare pranë

Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Penale. Bazuar ne ligj dhe vendimmarrjet e Këshillit për kandidim në jo më shumë se tre pozicione, heq dorë nga kandidimi im në pozicionin e lirë civil, të shpallur me vendimin nr.244, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Juridiksionit te Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Ndodhur në këto rrethana, duke iu referuar tërheqjes së kërkesës bërë nga kandidatja për të vijuar më tej procedurat e saj të ngritjes në detyrë si dhe mbështetur në vendimin e Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, pasi kemi bërë verifikimet përkatëse parashtrajmë përpara Këshillit sot relacionin së bashku me projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Juridiksionit te Përgjithshëm për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 244/2024 (*lapsus viti*, 2023) të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit z. Kurushi!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

6.1 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 256, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

6.2 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 257, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

6.3 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.⁴

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 14:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Naureda Llagami

(kryetare)

2. Ilir Rusi

(zëvendëskryetar)

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 4 sipas rendit të ditës.

- | | |
|---------------------------|------------------|
| 3. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 4. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje *znj. Irena Plaku.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
2. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

6.1 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 256, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

6.2 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 257, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

6.3 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 256, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në këtë çështje nuk merr pjesë znj. Irena Plaku.

Atëherë, për më shumë detaje fjalën ia jap z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, do të mirëkuptoja durimin tuaj në rastin konkret pasi do më duhet të pasqyroj me transparencë të gjithë relacionin dhe përveç tij edhe dy komunikimet më të fundit që kanë ardhur tani në mëngjes dhe bënë shkak për vonesën time në këtë mbledhje, pasi më duhet të përgatisja mendimin e tyre. Njëkohësisht do t’i pasqyroj me korrektësi, siç edhe karakterizon zakonisht metodën e punës së Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Pra jo vetëm relacionin por njëkohësisht edhe pretendimet e dy kandidatëve të cilët sot në mëngjes kanë investuar dhe në këtë kuadër kanë gjetur dhe vlerësimin tim maksimal sepse më në fund gjetën rrugën institucionale të adresimit të problemeve.

Po e filloj me zonjën... për nga renditja kronologjike në bazë të së cilës është bërë edhe dërgesa e e-mailit. Po e filloj me zonjën {...} e cila në përmbajtjen e ankimit të saj, në lidhje me projekt-relacionin që unë kam përgatitur për renditjen e kandidatëve për procedurën e lëvizjes paralele të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

Unë gjyqtare {...}, pasi u njoha me relacionin e dërguar nga ana juaj mbi projektvendimet për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257, 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili do të shqyrtohet në mbledhjen e datës 05.06.2024, parashtroj si më poshtë vijon:

Së pari, unë dhe gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, sikundër ju jeni në dijeni (këtë të fundit e marr me rezervë) kemi paraqitur një kërkesëpadi pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me palë të paditur Këshillin e Lartë Gjyqësor, me objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ vendim 222, datë 25.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës administrative të shpallura me vendimet 256, 257, 258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; shfuqizimin e aktit administrativ venim 221, datë 25.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës administrative të shpallura me vendimet 256, 257, 258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; skualifikimin nga procedura për lëvizje paralele të personave të tretë {...} si dhe {...}, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative të shpallura me vendimet 256, 257, 258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Kësisoj, vlerësoj se në kushtet kur nuk ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, lidhur me plotësimin e kriterëve ligjore për kualifikim të kandidateve {...} dhe {...} për procedurën e lëvizjes paralele në pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimet 257, 258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk mund të vijojë më tej me renditjen e kandidatëve.

Së dyti, unë dhe kandidatët {...} dhe {...} jemi diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2018-2019. Kandidatja {...} është diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020. Në këto kushte vlerësoj se pikëzimi dhe renditja e kandidatëve nuk mund të bëhet duke u bazuar në pikët e Shkollës së Magjistraturës, për sa kohë unë dhe dy kandidatët e tjerë {...} dhe {...} nuk kemi përfunduar Shkollën e Magjistraturës në të njëjtin vit akademik dhe rrjedhimisht kemi zhvilluar numër të ndryshëm të lëndëve mësimore, nuk mund të vendosemi në të njëjtat pozita me kandidaten {...}.

Së treti, zhvillimi i karrierës së magjistratit bazohet në vlerësimin profesional. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim kryerjen e vlerësimit profesional ka miratuar për gjyqtarët e emëruar në fillimin e viteve 2020 programin e vlerësimit për periudhën e

vlerësimit 2020-2022. Bazuar në ligjin 96/2016 dhe në praktikën e Gjykatës së Lartë (citon vendimin nr. 110, datë 13.03.2024 të Kolegjit Administrativ), vlerësimi dhe renditja e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele duhet të bëhet duke u bazuar në numrin e vlerësimeve profesionale ose mundësinë për të pasur vlerësime. Unë vlerësoj se për sa kohë në momentin e aplikimit në procedurën e lëvizjes paralele për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 257, 258 datë 24.05.2023 ka kandidatë, unë dhe disa nga kandidatët e tjerë, që kanë plotësuar kushtin ligjor për të vlerësuar, pasi kanë 3 vjet kalendarike në detyrë, procedura e renditjes së kandidatëve duhet të bëhet bazuar në vlerësimet profesionale dhe jo sipas pikëve të marra në Shkollën e Magjistraturës.

Me respekt gjyqtare {...}.

Vijuese pastaj ka qenë, ka vijuar e-maili me përmbajtje më poshtë, siç do ta citoj, të zotit {...}, i cili pretendon që:

Unë gjyqtari {...}, pasi u njoha me relacionin e dërguar nga ana juaj mbi projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i cili do të shqyrtohet në mbledhjen e datës 05.06.2024, parashtroj qëndrimin tim si më poshtë vijon: Unë dhe gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, sikundër ju mund të jeni në dijeni (edhe këtë e pranoj me rezerva) kemi paraqitur një kërkesëpadi pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me palë të paditur Këshillin e Lartë Gjyqësor, me objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ vendimi 222, 25.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës administrative të shpallura me vendimet 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; Shfuqizimin e aktit administrativ venim 221, datë 25.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës administrative të shpallura me vendimet 256, 257, 258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; Skualifikimin nga procedura për lëvizjen paralele të personave të tretë {...} si dhe {...}, për pozicionet e

lira në fushën e së drejtës administrative të shpallura me vendimet 256, 257, 258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Kësisoj, vlerësoj se në kushtet kur nuk ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, lidhur me plotësimin e kriterëve ligjore për kualifikimimn e kandidateve {...} dhe {...} për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimet 256 - 258, 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk mund të vijojë më tej me renditjen e kandidatëve.

Pra kjo ishte përmbajtja e dy e-maileve të dërguara nga dy kandidatët të cilët kontestojnë vijimin e procedurës pa specifikuar cili do të ishte veprimi procedural të cilët del i nënkuptuar nëpër përmbajtjen e këtyre e-maileve. Pra ajo që është deduktoj është që ata kërkojnë një pezullim të procedurës me arsyetimin që unë sapo citova.

Natyrisht në mungesë të bazës ligjore nuk mund të ishte e plotë dhe investimit që i bëhet Këshillit të Lartë Gjyqësor. Normalisht përmbajtja e e-mailit duhet të kishte të inkorporuar edhe bazën ligjore përkatëse mbi bazën e të cilës kandidatët pretendojnë të bllokohet një procedurë administrative, për më tepër një procedurë e cila në raport me interesin publik është shumë e rëndësishme sepse Këshilli i Lartë Gjyqësor me veprimet e fundit që kryen plotësimin e vakancave në shkallë të ndryshme të sistemit gjyqësor parapërgatit dhe inkorporimin apo integrimin e trupës gjyqësore e cila pritet të finalizojë studimet në Shkollën e Magjistraturës (të cilët janë 32 magjistratë), pra ka një interes të theksuar jo vetëm publik, por edhe nga vetë kandidatët të cilët presin të integrohen në sistemin gjyqësor shqiptar i cili gjithashtu ka nevojë të ngutshme për gjyqtarë me qëllim edhe evadimin e dosjeve gjyqësore.

Gjithsesi, veprimi apo kërkesa e kryer më duket jo vetëm pa bazë ligjore por ka rënë edhe në dekadencë. I gjithë veprimi i relatorit është kryer mbi bazën e një akti të redaktuar dhe për punën e së cilës kam vlerësimin maksimal për kontributin e paçmuar të ish-titullares së tij komisioni, e cila vijon të na mungojë në raport me kontributin që ka dhënë, dhe bëhet fjalë për vendimin 346, datë 27.06.2023 i cili ka miratuar listën e gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim si dhe gjyqtarëve që nuk kanë ose nuk mund të kenë asnjë vlerësim për efekt kandidimi në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shpallura me vendimet e

Këshillit të Lartë Gjyqësor 248 – 258 datë 24.05.2023, ku midis të tjerave, në Shtojcën 3, zoti {...}, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, i transferuar përkohësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, 01.07.2023 gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, figuron tek lista e gjyqtarëve që nuk kanë ose që nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Zonja {...}, gjyqtare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, e transferuar përkohësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, pas datës 01.07.2023 gjyqtare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, gjithashtu figuron në të njëjtën shtojcë, tek lista e gjyqtarëve që nuk kanë ose që nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Në projektrelacionin në të cilin bashkëshoqëron këtë vendim, për zotin {...} thuhet që: I emëruar gjyqtar në datën 09.01.2020 (mbetet për t'u verifikuar), nuk mund të ketë asnjë vlerësim pasi ky gjyqtar e ka përvojën trevjeçare profesionale në datën 09.01.2023 dhe nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2023 ku janë përfshirë të gjithë gjyqtarët që kanë plotësuar periudhën trevjeçare të vitit 2022.

Për zonjën {...} është i njëjti tekst: Emëruar gjyqtare në datën 09.01.2020. Nuk mund të ketë asnjë vlerësim pasi kjo gjyqtare e ka plotësuar përvojën trevjeçare profesionale në datën 09.01.2023 dhe nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2023 ku janë përfshirë të gjithë gjyqtarët që kanë plotësuar periudhën trevjeçare të vitit 2022.

Pra ky vendim është në fuqi sepse i është njoftuar rregullisht kandidatëve dhe momenti i njoftimit të aktit administrativ, në rastin konkret të aktit 346, datë 27.06.2023 është i rëndësishëm, paraqet një aspekt të rëndësishëm ligjor, pasi lidhet me të drejtat dhe detyrimet e kandidatëve dhe njëkohësisht përcakton/është përcaktues për pasojat juridike të krijuara pas botimit apo njoftimit të tij. Nga ky moment kandidatëve i kërkohet zbatimi i urdhërimeve të aktit dhe njëkohësisht i fillon përgjegjësia ligjore, natyrisht edhe kur nuk është dakord për zbatimin e saj. Gjithashtu i lind e drejta të ankohet ndaj këtij akti në organin administrativ nga momenti që i është komunikuar.

Pra siç po rezulton, ose të paktën siç po arsyetohet, akti më del në fuqi dhe si i tillë çdo ankim në lidhje me të ka rënë në dekadencë.

Gjatë pretendimeve të parashikuara me e-mail, më njoftojnë që paska një padi, të cilën nuk isha në dijeni zyrtarisht, padi të cilën e kam tërhequr nga Drejtoria Juridike dhe në përmbajtjen e tij gjej disa, të themi, konfirmime, bazuar po në aktin të cilin unë citova (346, 27.06.2023), ku në paragrafin e parafundit, ndër të tjera thuhet që minimalisht ajo ka aksesin për të verifikuar të gjithë dokumentet e dosjes, të kandidatëve, duke përfshirë edhe pikët e Shkollës së Magjistraturës, baza ku do të bazohet renditja me pikë e kandidatëve sepse janë përcaktuar që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, të të gjithë kandidatëve në procedurë.

Pra edhe në këtë procedurë, edhe në këtë padi që kanë investuar gjykatën, ku nuk kërkohet një pezullim minimalisht, përsëri më rezulton ku të jenë pranuar efektet, në opinionin tim, të aktit 346, 27.06.2023.

Si i tillë e konsideroj të pabazuar si përmbajtje. Natyrisht do doja që në lidhje me të, të shpreheshim paraprakisht përpara se të filloj të relatoj, të themi, përmbajtjen e relacionit tim, dhe gjithashtu do t'i rivlerësoj përsëri për komunikimin institucional të cilin kanë kryer dhe faktin që mendimi im nuk do të kishte vlerë pa mendimin ndryshe të këtyre kandidatëve. Kështu që në këtë aspekt unë mendoj si veprim procedural të miratojmë nëse do duhet të bëjmë ndonjë veprim, të marrim ndonjë veprim të ndërmjetëm procedural apo jo, apo do duhet të vijojë përsëri pastaj me relatimin e projektvendimit të cilin unë kam përgatitur. Vendosi ju!

Gentiana Muçaj: Për kërkesën..? Për të pritur gjykimin apo për të...? (pa mikrofon).

Alban Toro: Pra kërkesa nuk kishte të formuluar, të artikuluar në mënyrë të drejtpërdrejtë një pezullim, por thotë ndalo procedurën.

Gentiana Muçaj: Unë mendoj që ne duhet ta presim gjykimin, sepse nga ai vendim, nga shfuqizimi i atij vendimi varet edhe ky vendimi sot, ligjshmëria e këtij vendimi sot, varet edhe ligjshmëria e vendimit përfundimtar të procedurës. Ajo që ne kemi magjistratët për të emëruar, dy kandidate kanë të komanduara. Nuk hapin asnjë vend. {...} dhe {...} janë të komanduara, njëra në Këshill, tjetra në Gjykatën e Lartë, që

34

nuk hap asnjë vend për magistratët e rinj. Apo jo? Kështu që nuk ka urgjencë. Nuk ka nxitim Këshilli për t'i emëruar këto. Unë kështu e mendoj.

E dyta, kërkesa e dytë ishte për vlerësimin, për vlerësimet profesionale të tyre?

Për ndalimin, unë jam dakord që ne... unë mendoj që ne duhet të presim gjykatën. Derisa të shprehet gjykata, është vendimi i formës së prerë dhe pastaj.. Padia është për vendimin e kualifikimit, shfuqizimin e vendimit të kualifikimit herën e kaluar.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Po të {...} dhe të {...} bashkë.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Atë e gjen gjykata, a ka të drejtë apo s'ka të drejtë, legjitimohet apo s'legjitimohet ai e thotë gjykata. Ne nuk mund të themi dot që ai nuk legjitimohet. Pse s'paska ai të drejtë të legjitimohet.

(Zonja Llagami kërkon që anëtarët të ndezin mikrofonat kur flasin.)

Gentiana Muçaj: Mira, unë them parimisht që nuk e pezullon. Dakord? Gjykimi nuk e pezullon. Ne s'kemi një kërkesë për sigurim padie. Pastaj i takon gjykatës. Ne s'mund të marrim rolin e gjykatës. Dakord? Parimisht nuk e pezullon. Ai nuk e pezullon gjykimin. Dakord? Nuk e pezullon gjykimi këtë veprimtarinë /këtë procedurën këtu. Por për të mos u vendosur nesër-pasnesër në vështirësi ne në një rast të mundshëm që gjykata i shfuqizon ato vendime, si do procedojmë ne?

Fatmira Luli: Merret një vendim për mua dhe kërkon ti të drejta nga dikush tjetër. Këto dy procese s'kanë lidhje fare me njëra-tjetrën. Absolutisht s'kanë lidhje.

Gentiana Muçaj: Si s'kanë lidhje me njëra-tjetrën ato?!

Në qoftë se ti e ke kualifikuar në kundërshtim me ligjin, s'mund ta rendisësh, s'mund ta kualifikosh atë. Si s'paskan lidhje ato?!

Domethënë paligjshmëria e atij vendimit të parë të kualifikimit sjell paligjshmëri të këtij vendimi që do marri sot Këshilli, sjell paligjshmëri të vendimit përfundimtar. Si s'paska lidhje?!

Interesin e ligjshëm nuk po e diskutoj sepse i takon gjykatës ta diskutojë.

Unë mendoj që ne nuk kemi ngutshmëri për vakancat dhe për të mos e pritur vendimin e gjykatës.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Jo nuk ke sepse dy kandidate i ke të komanduara. Çfarë hapin këto? Çfarë vendi?

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Gjykatën e Tiranës e hap ti, do bësh lëvizje paralele, do shpallësh lëvizjen.

Alban Toro: E pra, janë procedura që kërkojnë kohë.

Fatmira Luli: Ne s'kemi hapur vende në Gjykatën Administrative vetëm për këto dy persona. Ne kemi hapur vende, janë disa vende. Sa vende janë në gjykatën e shkallës së parë?

Pesë! - Atëherë janë pesë vende. Nuk bëhet fjalë për dy veta, që s'ka urgjencë.

Gentiana Muçaj: Nuk po them këtë. Po them që s'ka urgjencë për emërimin e magjistratëve të rinj, në rregull, për të krijuar një vend vakant për shembull në Gjykatën e Korçës. Në Korçë është kjo?

Alban Toro: Po!

Gentiana Muçaj: Në Korçë. Dakord?

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Jo, s'ka! S'ka sepse kjo është e komanduar në Gjykatën e Lartë. Kjo tjetra është e komanduar.

(Zoti Toro flet pa ndezur mikrofonin.)

Suprimoja ashtu siç ia suprimove në shkurt të tjerëve. Po, si ia suprimove në shkurt të tjerëve. Në rregull?

Alban Toro: Kur i kam suprimuar?

Gentiana Muçaj: Po, në shkurt.

Transferim pa pëlqim.

Alban Toro: Po ngatërron skemën.

Janë dy skema krejt të ndryshme.

Nuk kam suprimuar. Kanë qenë pozicionet e plotësuara dhe gjyqtari nuk kishte gjykatë. Dhe si e tillë kam detyrimin që kur filloi lëvizja paralele ta transferojë në një gjykatë ku ka vend.

Gentiana Muçaj: Kishte gjykatë gjyqtari.

Alban Toro: Dhe mos më thuaj që nuk paska rëndësi lirimi i vendit të {...} me atë në Korçë, lirohen dy vende Tiranë dhe Korçë.

Gentiana Muçaj: Tiranën nuk e liron dot Alban, sepse e ke procedurë më vete.

Alban Toro: E liron, sepse filloj procedurën e lëvizjes paralele për atë vend.

Marr dikë nga rrethet dhe e përcjell atje. Si nuk e liruakam dot? Dhe duhet ta bëj sa më shpejt.

Gentiana Muçaj: Unë jam që të presim vendimin e gjykatës.

Alban Toro: Edhe ju Genta, si kolegët e tjerë, nuk justifikuat një bazë ligjore mbi të cilën unë duhet ta ndaloj këtë procedurë, sepse normalisht investohet...

Tani pa bazë ligjore si mund të eci para?

Absolutisht asnjë s'kam prit.

Pa bazë ligjore s'kam prit asnjë dhe as kam ndërmend të pres asnjë pa bazë ligjore.

(Zonja Muçaj flet pa ndezur mikrofonin.)

Alban Toro: Genta s'po bëjmë debat tani. Unë të dëgjova me respekt, tani e kam unë, meqenëse kam përgatitur këtë relacion.

E dyta, përveç mungesës së bazës ligjore unë jam bazuar tek vendimi që vetë ju, pra jo ju, Komisioni i Vlerësimit ka përgatitur, nuk e kam bërë unë, dhe ne kemi miratuar atë raport që ka bërë Komisioni i Vlerësimit, dhe ka thënë: Albani dhe Hyseni janë kandidatë që nuk kanë asnjë vlerësim dhe si të tillë do trajtohen, ligji e ka përcaktuar se si bëhet vlerësimi i personave me pa asnjë lloj vlerësimi. Tani, duke pasur një vendim të formës së prerë që ka dhënë pasoja, unë t'i them jo, nuk i njoh pasojat, nuk më përkon as me...

Programi, vendimi, pra çdo gjyqtar, bazohet për miratim vlerësimi tek një listë.

Emona Muçi: Atëherë, në lidhje me pretendimin, në lidhje me vendimmarrjen e vitit 2023 për mundësinë e pasjes së vlerësimeve të kandidatëve që kanë aplikuar në këto vende, domethënë në situatën aktuale kemi një ndryshim. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 215, datë 13.03.2024 ka përcaktuar që ({..} kundër Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me person të tretë E.M) ka përcaktuar/ka interpretuar që qenia ose jo në program vlerësimi nuk përbën ndalesë në lidhje me pasjen e vlerësimeve. Që do të thotë që në rast se personi/magjistrati ka plotësuar kohën për të pasur dhe mundësinë ligjore për të pasur një vlerësim, Këshilli është i detyruar për ta ndërmarrë.

Tani, në dritën e këtij vendimi, por edhe të një vendimi që ne kemi marrë, (nuk i mbaj mend numrat por diku nga data 18 ose 20 janar) që kemi përcaktuar programin e vlerësimit në rastin konkret për vitin 2024, ne kemi përfshirë pikërisht disa nga këta kandidatët dhe i kemi përfshirë me kohën, pra me vitin 2020-2021-2022 (pra trevjeçarin). Ky trevjeçar përkon me mundësinë e pasjes së një vlerësimi, edhe të miratuar nga vetë ne, përpara datës së aplikimit të këtyre vendeve. Përsëri ky Këshill i ka marrë të dy këto vendime. Për shembull është edhe kjo pengesë për t'u diskutuar. Faleminderit!

Alban Toro: Të them diçka për vendimin, se e bënë vendimin sikur është vendim i kolegjeve të unifikuara. Ky është një vendim, si gjithë vendimet e tjera që jep Gjykata e Lartë, e cila nuk mund të merret si bazë për unifikime praktikash, sepse nuk është i tillë

dhe për më tepër paraqet dy kandidatë dhe një fakt juridik krejt të ndryshëm në rastin konkret. Këtu janë dy kandidatë i cili njëri e ka dyvjeçar vjetërsinë në punë dhe tjetri e ka trevjeçar, dhe këta i kanë rënë shkurt, kanë bërë atë vlerësimet e tyre siç bën zakonisht Këshilli i Lartë i Prokurorisë, por që nuk kanë asnjë bazë krahasimore me gjithë punën që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor në vlerësimet e gjyqtarëve, dhe si i tillë nuk mund ta marrë fare në konsideratë për sa kohë që nuk është i formës së tillë që të unifikojë praktikën gjyqësore në raport me çështjet që parashtrihen aty. Përpos faktit që nuk parashtrajnë, nuk kanë të njëjtin fakt, nuk trajtojnë të njëjtin fakt juridik.

E dyta që doja të thoja është, ne kemi standardet që kemi mbajtur, znj. {...} i kemi refuzuar vlerësimin sepse i mungonte një muaj, në 12 muajt i mungonte një muaj, dhe i thamë nuk e bëjmë dot sepse viti e kërkon fillon nga 1 janari – 31 dhjetor. E ku ta çojmë ne këtë vendim, këtë standard që kemi miratuar? Apo i bëjmë në listë të gjitha dhe meqenëse na doli ky rasti këtu, hajde t'i... edhe të tjera, se kjo mu kujtua për momentin.

Naureda Llagami: Të lutem mund të komunikojmë, për efekt të transparencës, të lutem shtypni butonat.

Alban Toro: Genta mos na trego 19 janar, sepse të gjithë emërimet kanë qenë peng i institucioneve të caktuara dhe është bërë emërimi në janar por punën e kanë filluar në fund të janarit.

(Zonja Muçaj flet pa ndezur mikrofonin.)

Ka rëndësi, se po të tregoj praktikën dhe vlerësimet janë ato që na kanë drejtuar. Vlerësimet na kanë drejtuar.

Tani meqenëse në vlerësimet na ndryshohet kompozimi...

(Zonja Muçaj flet pa ndezur mikrofonin.)

T'i ruajmë standardet, se krijon sigurinë juridike, dhe cenon sigurinë juridike.

Gentiana Muçaj: Kur bën kualifikimin nuk merr vetëm programin që ka miratuar Këshilli apo Komisioni i Vlerësimit. Jo, jo! Ti do shikosh sepse ai mund të mos jetë në atë moment kur është bërë programi por mund t'i plotësojë më vonë, dhe ti këto

39

plotëson, ky i ka plotësuar apo nuk e ka plotësuar kushtin trevjeçar. Në rregull? Dhe këta rezultojnë...

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Mira të lutem! Të lutem Fatmira shtype.

Gentiana Muçaj: Programi është për Këshillin, nuk është fare për gjyqtarin dhe gjyqtarit s'i intereson fare çfarë programesh bën Këshilli. Programi është si urdhër pune për mua. Për mua programi është si urdhër pune. Unë si Këshill në vitin 2024 do bëj 20 vlerësime. Por kjo nuk më ndalon mua që unë të bëj 25 apo 30. Dakord?

Unë nuk kam paraqitur kërkesë, ju nuk më keni futur mua në as edhe një program. Në 2023 paraqita kërkesë për në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Fatmira Luli: Ne nuk miratojmë ato që në momentin që bëhet programi nuk kanë bërë vitin.

Gentiana Muçaj: Mira të lutem. Ti nuk do më bësh mua vlerësim se s'më ke futur në program vlerësimi? Jo! Ti do më bësh... E mora hipotetike.

Kjo do të thotë që ti mua s'do më bësh vlerësim se unë nuk jam në program vlerësimi edhe pse kam 20 vite gjyqtare?

Fatmira Luli: Është e përcaktuar në ligj se si bëhet vlerësimi.

Gentiana Muçaj: Vlerësimi nuk bëhet vetëm nga programi.

(Dy anëtarët flasin njëherësh.)

Fatmira Luli: Ne kemi miratuar ca akte që me këtë që ngre po i bën nul.

Gentiana Muçaj: Unë kështu them. Unë jam për t'u bërë vlerësimi i tyre. E kam thënë edhe në mbledhjet e mëparshme.

Ke në programin e 2024, duke i njohur vitin e plotë 2020. 2020 ia ke njohur në programin e 2024, ne si Këshilli ia kemi njohur 2020 të plotë.

Sa e tha Emona. 2020-ën, në 2024-ën. 2020-2021-2022.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Fatmira Luli: E keni propozuar ju *(i referohet komisionit të vlerësimit)* dhe e kemi miratuar ne? Pa bërë vitet?

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Naureda Llagami: Atëherë edhe një herë, për ta orientuar edhe një herë diskutimin. Të lutem! Të lutem!

A mundet ta kalojmë dot sepse ky është një diskutim

Edhe një merak tjetër, se më duket se po kalojmë prapë tek një çështje që ne e kemi diskutuar edhe tek mbledhja e kaluar, ndërkohë që relatori e kishte për pjesën procedurale. Pra jemi në pjesë procedurale. Lidhur me pjesën e çështjes për sa kohë çështja është bërë objekt shqyrtimi në gjykatë, kjo do jetë pjesë e vlerësimit të gjykatës, pra që gjykata mund t'i hyjë dhe mund të bëjë një vlerësim, sikurse ka bërë nga KLP-ja, mund ta bëjë edhe për KLGJ-në, mund të ketë të gjithë diskrecionin e vet gjykata ta bëjë këtë gjë, ndërkohë që ne këtu jemi në një procedurë administrative. Nuk kemi një kërkesë për pezullim procesi nga ana e gjykatës, edhe pse është bërë padia, -a mundemi ne dot të pezullojmë procedurën administrative? Ky është diskutimi. Pra jemi në kushte për të pezulluar procedurën administrative. Kjo më duket ishte dhe çështja që ngriti relatori. Pjesa tjetër pastaj, aq më shumë që çështja ka shkuar në gjykatë, kjo s'është pjesë fare më që ne të diskutojmë. Ne kemi bërë vlerësimin tonë. Vlerësimi ynë ka qenë me vendimmarrje, si vendimmarrje në kualifikimin e kandidatëve që janë me vlerësimi, s'janë me vlerësim; pasi edhe Këshilli ka diskrecion në vlerësimin e këtyre kandidatëve, duke programuar punën e tij, Këshilli nuk mund të eci në një punë kaotike, duke thënë që janë të gjithë, pra ka një prioritet punësh. Këshilli kështu ka vepruar dhe kështu orientohet nga ligji që të veprojë Këshilli. Megjithatë kjo është pjesë e diskrecionit që do bëjë vlerësim Gjykata Administrative për sa kohë është ngritur kualifikimi dhe shumë

41

çështje, dhe mund t'i hyjë. Ne nuk jemi tek kjo pjesë. Ne jemi tek kërkesa që ka parashtruar një nga kandidatët me të drejtë, e cila do të mbrojë të drejtën e saj për sa i përket pjesës së pezullimit të procedurës me pretendimin që ka dhe një vendim të Gjykatës së Lartë, vendim të cilin tashmë e kemi të disponuar. Problemi i vendimit është që nuk i kundërdrejtohet KLGJ-së, nuk i kundërdrejtohet akteve ligjore dhe nënligjore që ka KLGJ-ja. Ne mund të kemi baza të njëjta ligjore por unë nuk di çfarë aktesh kanë miratuar KLP-ja. Kjo është pjesë që unë kërkoj, dhe të paktën çfarë kuptova nga relatori, që kërkon vendimmarrje. A jemi në kushte që ne të pezullojmë procesin tonë këtu për shkak të një vendimi dhe një kërkesë që bën kandidati. Këtë kam unë për diskutim. Këtu dua që të fokusohet debati.

Emona Muçi: Kam një propozim.

Në qoftë se neve pretendojmë ose mendojmë ose parashikojmë që këto e-maile janë të paspecifikuara ose janë me të meta, a mund t'i njoftojmë dhe t'i lëmë kohë që të na paraqesin atëherë në qoftë e ne kërkojmë proceduralisht të na e paraqesin proceduralisht kërkesën?

Domethënë ata e kanë paraqitur me idenë që do merret parasysh nga ana jonë. Në qoftë se ne i themi që është me të meta dhe ti s'më ke vënë bazën ligjore, domethënë i bie që në një farë mënyre u gjejmë një kleçkë dhe i përcjellim.

Ideja është, në qoftë se ti i thua që është me të meta, ai ka paraqitur një kërkesë dhe të thotë, domethënë deri në momentin e shprehjes së vendimit të gjykatës....

Naureda Llagami: Nuk tha “me të meta”, në kuptimin e procedurës, se jemi organ administrativ. Relatori thjesht pasqyroj çfarë është shkruar dhe çfarë opinionioni kishte relatori mbi këtë. Nuk jemi në procedurë... Në procedurat që ka Këshilli, Këshilli futet në rend dite dhe ka shqyrtim këtë dhe relatori referon a kemi shkak ligjor. Sepse që ne të kemi shkak ligjor, duhet të kemi parasysh çfarë praktike ka Këshilli, pra duhet të pezullojmë të gjithë procedurat që kemi, për shkak të një shkak ligjor që ekziston.

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Nuk do t'ju mbaj shumë kohë. Nuk dua t'ju lodh me këto diskutime. Por mendoj se duhet të sqarojmë pozicionet tona në lidhje me shkresat dhe njoftimet në rrugë elektronike që kanë bërë ankuesit në këtë rast.

Ankuesit kanë kërkuar që të ndalohet, pra pa specifikuar edhe termin konkret, por të ndalohet procedura (e kuptojmë neve këtu) e vijimit të renditjes për kandidatët që ne i kemi sot objekt diskutimi bashkërisht.

Tani këtu jemi në një proces administrativ, i parashikuar nga ligji “Për statusin”, parashikuar nga ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, se si operon/vepron Këshilli i Lartë Gjyqësor në një proces administrativ. Procesi, sipas rregullave të përgjithshme vijon vetëm se kur... ekzistojnë dy mundësi ose dy raste që ai mund të pezullohet për shkak të një konflikti gjyqësor, e para nëse vetë ligji e parashikon si mundësi që kundërshtimi nëpërmjet padisë së veprimtarisë administrative, kundërshtimi që mund t'i bëhet kësaj veprimtarie në gjykatë, e thotë specifikisht që pezullon veprimtarinë, dhe ky nuk është rasti, nuk është rasti i parashikuar në procedurat që lidhen me përcaktimin e renditjes për kandidatët; dhe rasti i dytë është rasti kur vetë paditësit i drejtohen gjykatës dhe kërkojnë ndër të tjera edhe sigurimin e padisë, pra përveç padisë së themelit bëjnë edhe kërkesë për sigurimin e padisë, që është pezullimin e veprimeve administrative. Edhe kjo pikë e dytë nuk besoj se ekziston në këtë rast sepse nuk ka një vendim të gjykatës që të na autorizojë, të na ndalojë, të na urdhërojë, vijimin e mëtejshëm të procedurave. Pra nuk ka kërkim, nuk ka vendim, dhe vetë ligji në këtë rast nuk e pengon veprimtarinë e Këshillit në rast se palët, pra personat e interesuar bëjnë kërkesë në gjykatë dhe kundërshtojnë këto procedura.

Tani ne këtu flasim për parimet e ligjshmërisë. Ndodhur në këto kushte, nuk shoh asnjë lloj arsye pse nuk duhet të vijojmë ne procesin tonë sot. Nuk është hera e parë. Kemi pasur praktika të tjera që ne kemi vijuar procesin.

E dyta, përtej aspektit ligjor që po diskutojmë, jemi në përfundim të fazës së fundit të vlerësimit që duhet të ndërmarrin për kandidatët e vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës nga Shkolla e Magjistraturës dhe jemi në proces neve si Këshill, në procesin ne verifikimit të pasurisë dhe të figurës së tyre, sepse ka nisur si proces. Kështu që kjo veprimtari e sotme nuk mund të merret e shkëputur edhe nga veprimtaria në vijim e Këshillit mbas muajit qershor dhe muajit korrik, kur unë i shoh të ndërlidhura të dyja

këto situatat dhe e shoh jetike vijimin e procesit të zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në këtë kohë, me ato që na vijnë më pas, që janë hapjen e vakancave dhe caktimi në pozicion të magistratëve të rinj, që po ju kujtoj, që duhet ta mbyllim si proces deri në muajin korrik, dhe janë 32 magistratë që do të kërkojnë të sistemohen sipas ligjit në pozicionin e tyre si gjyqtar, në fushat administrative, dhe për këtë arsye ne kemi hapur dhe vendet administrative, ose në gjykatat me juridiksion të përgjithshëm.

Pra i shoh të dyja situatat të lidhura njëra me tjetrën dhe për sa kohë nuk ka (ajo çfarë është më kryesorja) një dispozitë ligjore që të na pengojë, të na ndalojë në veprimtarinë tonë të sotme, për të vijuar me procesin e vendimmarrjes në lidhje me propozimet që zoti Toro do të bëjë, unë e shoh këtë situatë që ajo kërkesë e bërë nga ana e të interesuarve nuk gjen mbështetje ligjore dhe për këtë arsye ne duhet të vijojmë procesin tonë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Po!

Emona Muçi: Atëherë, kam edhe unë një sugjerim.

Ky proces është shoqëruar, kjo procedurë në vetvete është shoqëruar edhe me disa kërkesa të tjera që neve jemi dashur për të marrë vendim, sikurse ka qenë dhe kërkesa për përjashtimin e disa prej anëtarëve të Këshillit të Lartë, pikërisht nga kjo procedurë. Tani, një nxitim dhe mospritje do të na vinte në dyshim. Realisht duhet të tregohemi më të qetë, më të urtë, të presim gjykatën. Është një rast që na bën nder. Pikërisht edhe nga qenia e këtyre personave momentalisht të cilët kanë humbur, të themi, pa arsye normalisht, por kanë humbur besimin ndaj nesh. Tani, ne, pse duhet të nxitojmë? Atëherë, presim gjykatën në momentin që shprehet dhe ne vijojmë. Ne këtu jemi. Ne për këto vendime jemi. Ky është mendimi im duke parë edhe historikun e kësaj procedure. Është Këshilli ai që vendos. Ky ishte thjesht një mendim personal. Faleminderit!

Naureda Llagami: Çështja që ngrihet i ka të dyja anët e medalies, ka anën e parë (për të vazhduar idenë e Emonës), çfarë do ndodhte nëse ne vijojmë dhe nëse gjykata vendos kualifikimin për një pjesë të tyre dhe për një pjesë jo, vendos në favor të palës? A do kishim ne mundësi që t'i rikuperonim të drejtën e humbur (këtë e ngre pyetje për Komisionin e Zhvillimit të Karrierës) palës së cilës i cenohet e drejta në këtë proces? Nëse ne do kemi mundësi që t'ia rekuperojmë të drejtën, unë do sugjeroja që ne të vazhdojmë procesin. Nëse ne do jemi pastaj në vështirësi, këtë në fakt e dua një çështje për ta ngritur në diskutim me ju. Çfarë do të ndodhte në situatën që gjykata do i jepte të drejtë? Pra do kemi ne mundësi, në aspektin e administrimit?

Alban Toro: T'ia lejmë gjykatës të vendosi në të ardhmen se si rregullohen pasojat sepse aktualisht është investuar gjykata. Tani të marrim rolin e gjykatës, të zgjidhim pasojat.

Naureda Llagami: Thjesht diskutim.

Alban Toro: Ne kemi skualifikuar kandidatë të cilët nuk kishin mbaruar problemet e tyre me KPA-në dhe tashmë ata kanë humbur të drejtën për të qenë pjesë e Gjykatës së Lartë, në një kohë që sistemi kërkonte plotësimin e vendeve të Gjykatës së Lartë.

Kështu që po të fillojmë të bëjmë arsyetime të tilla: si do të fitohet e drejta; si do rregullohen pasojat, i bie të stopojmë çdo gjë dhe hajde presim çdo gjë. Ama gjykatat nuk mbushen me këtë pjesë. Nëse ia lejmë të drejtën gjykatës dhe gjykata e ka këtë të drejtë, mund të vendoste (se po bëj dhe rolin e gjyqtarit tani), mund të vendoste pezullimin. Ata, vetë kandidatët, kërkonin pezullimin, edhe të kësaj procedure. Por s'ka kërkuar njeri pezullimin. Tani ta vetë pezullojmë dhe nga ana tjetër pastaj të gjendemi përballë Parlamentit dhe të thotë pse s'ke plotësuar vendet, pse s'ke plotësuar vakancat, -nuk e di se si do e vazhdoni këtë pjesën e plotësimit të vendeve. Jua kam thënë, unë jam për ikje.

Naureda Llagami: Të gjithë për ikje jemi. Problemi është që...

Alban Toro: Ikjen tonë po e përshpejtojnë.

Naureda Llagami: Jo, të gjithë jemi për të ikur një ditë, por i vetmi problem është që si mund ta adresojmë. Unë jam dakord në fakt që neve për sa kohë ato vetë s'e kanë kërkuar, a mundemi ne? Se procesi gjyqësor, siç rezulton, mirë që është në Gjykatë të Apelit Administrativ, por mund të ketë edhe rekursim të çështjes dhe ne pastaj ngelemi në një rreth vicioz që nuk i japim dot zgjidhje.

Unë dua një pyetje definitive. Sa vende vakante hapen nga mbyllja e këtyre pozicioneve? Hapet vend vakant? Këtë e dua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Hapen vende vakante.

Klodian Kurushi: Hapen disa vende vakante. Hapen në Gjykatën e Shkallës së Parë Lushnje, se do bëhet lëvizja. Mund të jetë një, mund të jenë dy që të hapen në Lushnje. Nëse mund të jetë një që hapet në Lushnje, dy të tjerat mund të hapen një në Tiranë dhe një në Korçë.

Naureda Llagami: Po ke për t'i dhënë përgjigje edhe shqetësimit të Gentës, që kemi hapje të vendeve vakante.

Klodian Kurushi: Do hapen vendet vakante, jo sepse duam neve, do hapen vende vakante për të sistemuar magjistratët e rinj.

Naureda Llagami: Jo, çështja e vendeve vakante Mona është shumë problem sot, sepse neve na duhen vende vakante për një muaj dhe nëse ne një vendim dhe shumë vendime, dhe në fakt jeni ju Komisioni përgjegjës që duhet të zhblokoni dhe të ecim shpejt me vlerësimet, është që ne duhet t'i marrim tashmë sa më shpejt për të mundësuar hapjen e 32 vendeve vakante. Dhe pyetja ime e drejtpërdrejtë është: Nëse ne na garanton që lëvizjet e caktuara ne na hapin në korrik vende vakante, ok, pastaj ne nuk mundemi, nuk e kemi luksin që të shkojmë...

Klodian Kurushi: Çfarë do thotë gjykata?

Po tani të mos hedhim fall.

Çfarë do vendosi gjykata, do bëjmë edhe ne.

Gentiana Muçaj: {...} e ka tjetër, kjo e ka tjetër.

Kjo është një procedurë.

E ku është pastaj nxitimi këtu?

Çfarë përfitojë Këshilli këtu?

Ta zëmë, hipotetike, gjykata vendos shfuqizimin e atij vendimi, për pasojë ti do shkosh tek kualifikimi. Ne do shkojmë tek kualifikimi i kandidatëve. Do fillojmë procedurën, kualifikim-renditje dhe pastaj lëvizje paralele. Po ata që kanë shkuar atje ndërkohë dhe japin detyrën? Ata që kanë shkuar, që janë emëruar në kundërshtim me ligjin, qenka gjykatë pa ligj. Kështu i bie. Atëherë për të parandaluar një paligjshmëri...

Gjyqtarin e GJKKO-së e çove me emërim të përkohshëm në Tiranë, me caktim të përkohshëm, e çove në Tiranë. Pavarësisht se ai më pas tha që unë nuk jam dakord, dua atje.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin – “Njëri në Tiranë dhe tjetri në Berat”.)

Po, Tiranë, Berat. {...} ka qenë në Tiranë.

Naureda Llagami: Të dy sot, për shkak të ekzekutimit të vendimit, kjo për të thënë që Këshilli reagon... *(Vijon fjalën pa mikrofon..)*

Gentiana Muçaj: Nuk e kishe procedurë “pending” ti emërimin e {...} në GJKKO dhe që ti e caktove. Jo, jo, nuk e kishe procedurë këtu në Këshill. Ndryshon. Këtu ke tashmë një procedurë të hapur. Tek {...} nuk e kishe. Ndryshojnë. Tek {...} nuk e kishe procedurë këtu në Këshill, të hapur.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin)

Ekzekutimin e gjykatës? Ekzekutimin e gjykatës e kemi detyrim ligjor ta zbatojmë.

Unë po të them çfarë përfiton Këshilli nga mospritja e vendimit të gjykatës? Ky nxitimi, kjo emergjenca.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin)

Meqenëse qenkan numra, kjo është një procedurë që ka filluar në maj 2023. Jemi në qershor 2024 ne tani. Ku paska qenë kjo emergjenca kaq e madhe e Këshillit, pas një viti e gjysmë? Dakord?

Klodian Kurushi: Mirë e ngrite si shqetësim.

Ta jap përgjigjen.

E ke ngritur shumë mirë këtë. Vetëm ngrini kështu.

Tani, të ta sqaroj edhe këtë pjesën?

Gentiana Muçaj: Po flasim për emergjencën.

(Ka ndërhyrje nga disa anëtarë njëherësh.)

Klodian Kurushi: Për emergjencën po flasim.

Do ta sqaroj edhe unë këtë pjesën.

A keni durim të flas? E bëtë pyetjen dhe po flas. Ta sqaroj!

Atëherë, që ta dini, viti që kaloi, ky Këshill ka caktuar në pozicion 40 magistratë, ku nuk ishin 40 vende të hapura, dhe i kemi shtyrë procedurat sepse nuk po i gjenim 40 vende të hapura deri në shtator, deri në shtator-tetor. I mbaruam ato procedura. Filluam të tjerat neve si Këshill prapë, që ishin ata të vitit të parë (ishin edhe një 40 tjetër). Bëmë verifikimin e kritereve, deri në dhjetor. Në janar pastaj diskutuam problemin e kuotave. Keni qenë edhe ju këtu (se hapëm ca kuota të tjera). Domethënë, puna vazhdon çdo muaj. Në shkurt hapëm ca vende të tjera në gjykatë të apelit, në lëvizje paralele dhe po në shkurt, në mars ka filluar vijimi i kësaj procedure. Domethënë, kjo procedurë nuk ka mbetur në raftet tona, se nuk është emergjente, por ka qenë në rend, siç kemi ne si gjyqtarë rend seancash gjyqësore, marrim dosjen e parë të regjistruar, duhet ta heqim; vjen e dyta në radhë, duhet ta heqim. Të njëjtën gjë kemi bërë edhe në këtë rast. Pra nuk kemi fjetur, por i kemi bërë të gjitha situatat në rend, dhe ka qenë kjo situatë që i ka ardhur radha në këtë kohë për t'u proceduar.

(Zonja Muçi flet pa ndezur mikrofonin.)

Klodian Kurushi: Emona, kush jeni ju dhe kush jemi ne?

Ne dhe ju, nuk e kuptoj këtë pjesën.

Emona Muçi: Jemi gjyqtare prej disa vitesh.

Po flas, ne të dyja që jemi kundër. Vetëm ne të dyja.

Klodian Kurushi: A jeni ju të dyja veç dhe ne jemi veç?

Emona Muçi: Ne të dyja që po flasim, që dashkemi të presim gjykatën.

Se unë po shoh, vetëm unë dhe Genta...

Naureda Llagami: Emona, shtype!

Klodian Kurushi: Jo, jo, shiko tani.

Ke të drejtë që mund të thuash mund ta kishim përfunduar, por si të gjitha proceset, edhe procesi ynë është proces i përbashkët. Dhe ajo pjesa jonë, e jona (se tani po i ndajmë gjërat dhe më vjen keq që po i ndajmë), e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ka qenë korrekte me të gjitha afatet. Kemi pasur probleme me vlerësimet për disa kandidatë të cilët duhet të lëviznin paralelisht dhe të ngriheshin në detyrë, të cilët u ngritën, me planifikimet që kemi bërë, në muajin shtator, tetor, nëntor. Sepse kjo është puna. Dhe unë nuk ia vë fajin as Komisionit tjetër sepse edhe ata kandidatët kanë pasur probleme që po i diskutojmë prapë sot bashkë, probleme me ILD-në, probleme me KPA-në, probleme me gjykatat, me vlerësimet, me ankimet ndaj atyre vendimeve në procese gjyqësore.

Këto pra janë problemet, problemet e përbashkëta. Kështu që ne nuk kemi qëndruar, kemi punuar, por për fatin tonë edhe të mirë (ndonjëherë edhe të keq), puna jonë nuk është e vetme, nuk është përgjegjësi e vetme, por është punë që ndahet me disa institucione të tjera kushtuese. Kështu që në këtë pikë, ndonjëherë ne nuk ecim në të njëjtën njësi vale. Dikush ka prioritetet e veta si institucion, ne kemi prioritetet tona. Ne i kemi të ngarkuara me ligj prioritetet tona. Në muajin korrik duhet ta mbyllim situatën e caktimit të pozicion të kandidatëve për magistratë, por që ta mbyllim ne duhet të

mbyllen edhe proceset në ILD (që nuk mbyllen), duhet të mbyllen edhe proceset në KPA (që nuk mbyllen), duhet të mbyllen edhe proceset gjyqësore (që nuk mbyllen në atë kohë), përtej edhe ngarkesës që kemi edhe neve si institucion, se s'po themi që jemi të parët në gjithçka.

Emona Muçi: E dimë datën e seancës? (Pa mikrofon)

Klodian Kurushi: Do më lësh të flas?

Mos më kalo tek data e seancës tani, se s'po flas për seancën, të lutem.

Emona Muçi: Të kemi një ide. (Pa mikrofon)

Klodian Kurushi: Nuk kam biseduar me gjyqtarët e të flas se kur e keni seancën.

Emona Muçi: A e përfaqëson Këshilli? A e përfaqëson? (Pa mikrofon)

Klodian Kurushi: A ta mbaroj këtë pjesën? Tjetër gjë po flas...

Emona Muçi: Ç'është kjo, s'flas në telefon me gjyqtarin?!

Çfarë janë këto situata?!

Klodian Kurushi: Ti më thua, a keni biseduar me gjykatën apo jo?

Emona Muçi: A keni biseduar me gocat që përfaqësojnë Këshillin, o Klodi! Ç'punë kemi me gjyqtarët? A e përfaqëson Këshillin? A shkon {...}, apo kush shkon? Unë e di sepse unë e kam pyetur {...}.

Klodian Kurushi: Çfarë po teston tani, a e di unë apo s'e di unë?

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Emona Muçi: Nuk kam pyetur asnjë person në lidhje me a është paraqitur ndonjë padi a s'është paraqitur. Rastësisht gjatë punës sime, në Komisionin e Vlerësimeve, për të marrë informacion në lidhje me vijimin e punës të nëpunëseve, kam marrë vesh që zonja {...} ndodhet pranë... Kaq! Dhe unë mora vesh që është ajo.

Naureda Llagami: Alban, ka mundësi edhe një herë të bësh propozimin tënd konkret për të lejuar Gentën të bëjë propozimin e vet konkret dhe neve të votojmë pas gjithë sqarimeve.

Alban Toro: Propozimi aktual, që në mungesë të bazës ligjore për të cilën kërkohet apo pretendohet ndalimi, nuk ekziston, nuk janë shkaqet e parashikuara në ligj, pra shkaqet e parashikuara edhe në Kodin e Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë, dhe si e tillë të vijojmë procedurën për efekt të vijimit dhe miratimit, dhe debatimit të projekt-akteve të cilat shoqërojnë relacionin.

Naureda Llagami: Po Genta, propozimi yt.

Gentiana Muçaj: Unë jam për të pritur ose për të shtyrë këtë seancë në lidhje me këtë mbledhje, në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, deri në vendimin e gjykatës, për të paraprirë çdo vendimmarrje të gjykatës që mund të ndikojë në vendimin e Këshillit.

Naureda Llagami: Atëherë, me procedurë, do të hedhim përpara propozimin e Gentës dhe pastaj të relatorit.

Ilir Rusi: Kundër.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Kundër. Për sa kohë nuk ka një vendim gjykate që e pezullon procedurën, jam kundër. Faleminderit!

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Markelian Koça: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet me shumicë votash.)

Naureda Llagami: Kalojmë në propozimin e z. Toro.

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Unë jam kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Me shumicë votash miratohet vijimi i shqyrtimit të projekt-aktit.)

Naureda Llagami: Vijohet me shqyrtimin e projekt-aktit.

Alban Toro: Me vendimin nr.256 - nr.258, 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e tre procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative. Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.02.2023.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet e Këshillit nr.256 – nr.258, datë 24.05.2023, kandiduan gjithsej 5 (pesë) kandidatë, sipas tabelës së mëposhtme, ku për 256-ën z. {...}, {...}, {...}, {...}, {...}; për 257-ën {...}, {...}, {...}, {...}, {...}; për 258-ën {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimeve 256-258, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë vetëm 1 (një) kandidat sipas vendimit respektiv, që është z. {...}.

Për kandidatin z. Lala, Këshilli me vendimin nr.45, 31.01.2024 ka vendosur: “Transferimin e gjyqtarit z. Lala, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë ku është caktuar në mënyrë të përhershme”.

Në pozicionet nr. 256- nr258 që i referohet lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk kishte kandidatë të kualifikuar me 2 (dy) vlerësime / apo 1 (një) vlerësim. Në këto rrethana Këshilli, në zbatim të pikës 49 të vendimit 320/2020, me vendimin nr. 161, datë 03.04.2024 ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256-nr.258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim”. Po në këtë vendim u caktuan nëpërmjet procedurës së shortit edhe relatorët për çdo kandidat, përkatësisht për: znj. {...}, z. {...} znj. {...} dhe znj. {...}.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit të lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësisht të kandidatëve të kriterëve të mëposhtme, parashikuar nga nenet 8, 43/6, dispozita e të cilave nuk i citoj.

Kandidatët e kualifikuar sipas pozicioneve që kanë aplikuar janë:

Për kandidaten znj. {...}, është vendimi nr. 219, datë 25.04.2024, i cili ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet nr. 256 – nr. 258.

Për z. {...}, vendimi nr. 220, datë 25.04.2024, i cili ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet të cilat cituam më lart.

Për kandidaten znj. {...}, kemi vendimin nr. 221, datë 25.04.2024, i cili ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele [...].

Për znj. {...}, kemi vendimin nr. 222, 25.04.2024, i cili ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionet e cituara më lart.

Duke qenë se për këto pozicione të lira, ishin kualifikuar të gjithë kandidatët, Këshilli caktoi nëpërmjet shortit relatorin e përzgjedhjes për këto pozicione.

Me cilësinë e relatorit administrova nga kandidatët njoftimin e tyre dhe njëkohësisht pretendimet eventuale të cilët mund të kishin në lidhje me relatorin apo anëtarë të tjerë të Këshillit.

Brenda afatit të parashikuar kandidati z. {...} me anë komunikim elektronik të datës 29.04.2024 paraqiti kërkesën për përjashtimin e relatorit, z. Toro dhe të anëtarëve të tjerë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës me arsyetimin si vijon: “Jam njohur me emailin tuaj, me anë të të cilit njoftohem për caktimin ndaj meje të z. Toro, si relator për këto procedura përzgjedhjeje për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 256 - nr. 258 dhe nëpërmjet këtij emaili bëhem me dije se kam të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Në përgjigje të këtij emaili, unë ju shpreh qëndrimin tim se jo vetëm z. Toro por edhe anëtarët tjerë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës duhet të përjashtohet në këto procedura, për arsye sa vijon. Në këto procedura ka marrë pjesë edhe një kandidate e cila është komanduar në njësinë ndihmëse pranë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite të jetë e tillë, pra, kjo kandidate është në varësi marrëdhënie pune direkte me anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës... etj.”, - përmbajtjen e të cilës ju jeni njohur gjerësisht edhe në seancën e kaluar në të cilën u refuzua kërkesa për përjashtim. Bëhet fjalë për vendimin nr. 256, 29.05.2024 me anë të të cilit është vendosur: “Për refuzimin e kërkesës së z. {...} *“Për përjashtimin e relatorit dhe të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nga procedurat për të cilat ai ka kandiduar për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”*”.

Siç u parashtrua në pikën 4 të këtij relacioni, kandidatët e kualifikuar për pozicionet nr.256 – nr.258 i përkasin kategorisë së kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe

profesional. Hapat dhe kriteret për renditjen e tyre janë parashikuar në mënyrë të detajuar në seksionin Ç.1 të Kreut VI të vendimit 320/2020.

Pika 102 e vendimit 320/2020 parashikon se: “Kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional renditen duke u bazuar në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin. Sipas këtij kriteri, kandidati me rezultatet më të larta, renditet më lart.” Për sa më lart, në respektim edhe të përfundimeve të vendimit të Këshillit nr. 346, datë 27.06.2023, këtyre kandidatëve nuk u bëhet asnjë vlerësim nga Këshilli.

Në zbatim të pikës 106, të vendimit të Këshillit 320, relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për kandidatët e kualifikuar. Konkretisht lidhur me vlerësimin e Shkollës së Magjistraturës, për kandidatët u konstatua se:

Zonja {...} e diplomuar në vitin akademik 2018-2019 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2016 - qershor 2019) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4070.31 pikësh, nga 4450 të mundshme.

Zoti {...} i diplomuar në vitin akademik 2018-2019 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2016 - qershor 2019) ka marrë vlerësimin “Shumë Mirë”, me një total prej 4073 pikësh, nga 4450 të mundshme.

Kandidatja znj. {...} e diplomuar në vitin akademik 2018-2019 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2016 - qershor 2019) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4129.37 pikësh, nga 4450 të mundshme.

Zonja {...} e diplomuar në vitin akademik 2019-2020 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2018 - qershor 2020) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 2990 pikësh, nga 3200 të mundshme.

Ndërkohë, gjatë procedurave së përzgjedhjes, kandidatja znj. {...} paraqiti një kërkesë, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 14.05.2024, nëpërmjet të cilës ka parashtruar heqjen dorë nga kandidimi për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.256, datë 24.05.2023 për lëvizjen paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Mbi këtë kërkesë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi përfundimin e procedurave lëvizjen paralele për këtë pozicion.

Lidhur me renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë pika 8 dhe 9 e nenit 43 të Ligjit për Statusin.

Po ashtu, për renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të vendimit 320/2020, dalë në zbatim të pikës 12, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “101. Për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional ndiqet një hap, në të cilin bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin dhe të detajuara më poshtë në këtë vendim.”

Fillojmë me renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 256, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 256, datë 24.05.2023, u përfshinë tre kandidatë, konkretisht: z. {...} znj. {...} dhe znj. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e lëvizjes paralele ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe nuk kishin asnjë vlerësim etike dhe profesional, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “b”, pika 8, e nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në pikën 101 të vendimit 320/2020.

Për renditjen e kandidatëve, u ndoq hapi i vetëm i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 8, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin Ç.1, Kreu VI, të vendimit 320/2020.

Sikurse u parashtrua edhe më sipër, sipas përcaktimeve të pikës 8, të nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe pikës 101, të vendimit 320/2020 ku parashikohet se: “Për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional ndiqet një hap, në të cilin bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin dhe të detajuara më poshtë në këtë vendim ...”.

Referuar kriterit të renditjes, pra atij sipas “renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës”, për kandidatët u konstatua:

Për kandidatin z. {...} a) Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 3-vjeçare Tetor 2016 - Qershor 2019, kandidati është vlerësuar në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Për znj. {...} a) Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 3-vjeçare Tetor 2016 - Qershor 2019, kandidatja është vlerësuar “Shumë mirë”.

Për znj. {...} a) Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 2-vjeçare Tetor 2018 - Qershor 2020, kandidatja është vlerësuar në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “renditjes së të diplomuarve”, rezultoi që kandidatët z. {...} znj. {...} dhe znj. {...}, të kenë nivelin e vlerësimit “Shumë mirë” në renditje. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të vlerësimit të Shkollës për kandidatët, identifikohen tre kandidatë me rezultate të njëjta në nivelin e vlerësimit. Për sa më sipër, duke qenë se të tre kandidatët e kanë nivelin e vlerësimit “shumë mirë” nga Shkolla e Magjistraturës, për pasojë, renditja e kandidatëve nuk mund të bëhet sipas nivelin të përgjithshëm.

Duke vijuar me përparësitë të parashikuara nga pika 103 nuk rezulton që ndonjë prej kandidateve të ketë përvojë si gjyqtar i komanduar apo në skemën e delegimit.

Në pikën 105 të vendimit 320/2020 përcaktohet se: “Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 103, të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar.”

Nga lista kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 256/2023, rezulton se ata i përkasin dy viteve akademike të ndryshëm në diplomim nga Shkolla e Magjistraturës. Dy kandidatët gjenden, konkretisht: z. {...} znj. {...} në listën e klasifikimit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në qershor 2019 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës; znj. {...} në listën e klasifikimit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në qershor 2020 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës. Qenia në vite akademike të ndryshëm nuk përbën pengesë ligjore për renditjen e tyre në pozicionin ku kandidojnë.

Nga listat e klasifikimit të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtarë të përcjellë nga shkolla e Magjistraturës, për vitin qershor 2019 dhe qershor 2020 ka rezultuar se:

i) kandidati z. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4073 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 91.52 %, të pikëve totale.

ii) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4129.37 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 92.79 %, të pikëve totale

iii) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 2990 pikë, nga 3200 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 93.44 %, të pikëve totale.

Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, sipas listës së klasifikimit të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 256, datë 24.05.2023, ku më lart renditet kandidatja znj. {...}, ndërsa kandidatët znj. {...}, z. {...} renditen pas saj.

Siç u argumentua më sipër, nuk ekziston pengesë ligjore për të kryer renditjen e kandidatëve të diplomuar në vite të ndryshme akademike, pasi renditja bazohet në vlerësimet e marra nga kandidatët e diplomuar në raport me pikët e mundshme. Znj. {...} është vlerësuar me 93.44 % të pikëve të mundshme, znj. {...} është vlerësuar me 92.79 %, të pikëve të mundshme, z. {...} është vlerësuar me 91.52 %, të pikëve të mundshme. Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 256, datë 24.05.2023, rezulton si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}; 3) Z. {...}.

Bazuar në sa përcaktohet në pikat 19-25, të këtij relacioni, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 26 të tij, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 256, 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Sipas pikës 1 të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 256, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}; 3) Z. {...}.

Natyrisht është parashikuar edhe hyrja në fuqi dhe forma e komunikimit.

Më pas kalojmë në renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 257, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 257, datë 24.05.2023, u përfshinë katër kandidatë: znj. {...}, z. {...} znj. {...} dhe znj. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e lëvizjes paralele ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe nuk kishin asnjë vlerësim etike dhe profesional, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “b”, pika 8, e nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në pikën 101 të vendimit 320/2020.

Për renditjen e kandidatëve, u ndoq hapi i vetëm i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 8, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin Ç.1, Kreu VI, të vendimit 320/2020.

Sikurse u parashtrua edhe më sipër, sipas për caktimeve të pikës 8, të nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe pikës 101, të vendimit 320/2020 ku parashikohet se: “Për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional ndiqet një hap, në të cilin bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin dhe të detajuara më poshtë në këtë vendim ...”.

Referuar kriterit të renditjes, sipas “renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës”, për kandidatët u konstatua:

Për znj. {...}, Certifikata e vlerësimit për periudhën 3-vjeçare Tetor 2016 - Qershor 2019, kandidatja është “Shumë mirë”.

Për z. {...}, Certifikata e vlerësimit për periudhën 3-vjeçare Tetor 2016 - Qershor 2019, kandidati është vlerësuar “Shumë mirë”.

Për znj. {...}, Certifikata e vlerësimit për periudhën 3-vjeçare Tetor 2016 - Qershor 2019, është vlerësimi “Shumë mirë”.

Dhe znj. {...}, për vlerësimin e periudhës 2-vjeçare Tetor 2018 - Qershor 2020, kandidatja është vlerësuar në nivelin “Shumë mirë”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “renditjes së të diplomuarve”, rezultoi që kandidatët znj. {...}, z. {...} znj. {...} dhe znj. {...}, të kenë nivelin e vlerësimit “Shumë mirë” në renditje. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të vlerësimit të Shkollës për kandidatët, identifikohen katër kandidatë me rezultate të njëjta në nivelin e vlerësimit. Për sa më sipër, duke qenë se të katër kandidatët kanë nivelin e vlerësimit “shumë mirë” (*ndërpritet audio dhe sipas relacionit vijon fjalia që po lexohej nga z. Toro*) ...nga Shkolla e Magjistraturës, për pasojë, renditja e kandidatëve nuk mund të bëhet sipas nivelin të përgjithshëm.

Duke vijuar me përparësitë të parashikuara nga pika 103 nuk rezulton që ndonjë prej kandidateve të ketë përvojë si gjyqtar i komanduar apo në skemën e delegimit.

Në pikën 105 të vendimit 320/2020 përcaktohet se: “Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 103, të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar.”

Nga lista kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 257/2023, rezulton se ata i përkasin dy viteve akademike të ndryshëm në diplomim nga Shkolla e Magjistraturës. Tre kandidatët gjenden, konkretisht: znj. {...}, z. {...} znj. {...} në listën e klasifikimit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në qershor 2019 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës; znj. {...} në listën e klasifikimit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në qershor 2020 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës. Qenia në vite akademike të ndryshëm nuk përbën pengesë ligjore për renditjen e tyre në pozicionin ku kandidojnë.

Nga listat e klasifikimit të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtarë të përcjellë nga shkolla e Magjistraturës, për vitin qershor 2019 dhe qershor 2020 ka rezultuar se:

i) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4070.31 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 91.46 % të pikëve totale;

ii) kandidati z. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4073 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 91.52 %, të pikëve totale.

iii) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4129.37 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 92.79 %, të pikëve totale.

iv) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 2990 pikë, nga 3200 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 93.44 %, të pikëve totale.

Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, sipas listës së klasifikimit të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 257, datë 24.05.2023, ku më lart renditet kandidatja znj. {...}, ndërsa kandidatët znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...} renditen pas saj.

Sic u argumentua më sipër, nuk ekziston pengesë ligjore për të kryer renditjen e kandidatëve të diplomuar në vite të ndryshme akademike, pasi renditja bazohet në vlerësimet e marra nga kandidatët e diplomuar në raport me pikët e mundshme. Znj. {...} është vlerësuar me 93.44 % të pikëve të mundshme, znj. {...} është vlerësuar me 92.79 %, të pikëve të mundshme, z. {...} është vlerësuar me 91.52 %, të pikëve të mundshme dhe znj. {...} është vlerësuar me 91.46 %, të pikëve të mundshme. Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 257, datë 24.05.2023, rezulton si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}; 3) Z. {...}; 4) Znj. {...}.

Bazuar në sa përcaktohet në pikat 30-36, të këtij relacioni, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 37 të tij, relatori përgatiti projektvendimin për renditjen e kandidatëve për pozicionin e hapur me vendimin nr. 257, 24.05.2023.

Në lidhje me renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 258, datë 24.05.2023, u përfshinë katër kandidatë, konkretisht: znj. {...}, z. {...} znj. {...} dhe znj. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e lëvizjes paralele ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe nuk kishin asnjë vlerësim etike dhe profesional, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “b”, pika 8, e nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në pikën 101 të vendimit 320/2020.

Vlen të theksojmë se ashtu siç u relatua për pozicionin e lirë nr. 257/2023 lidhur me zbatimin e kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “renditjes së të diplomuarve konstatohen se janë të njëjtit kandidatë dhe për pozicionin nr. 258/2023. Nga verifikimi rezultoi që kandidatët znj. {...}, z. {...} znj. {...} dhe znj. {...}, të kenë nivelin e vlerësimit “Shumë mirë” në renditje. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të vlerësimit të shkollës për kandidatët, identifikohen katër kandidatë me rezultate të njëjta në nivelin e vlerësimit. Për sa më sipër, duke qenë se të katër kandidatët e kanë nivelin e vlerësimit “shumë mirë” nga Shkolla e Magjistraturës, për pasojë, renditja e kandidatëve nuk mund të bëhet sipas nivelin të përgjithshëm.

Nga listat e kandidatëve magjistratë, profili gjyqtarë të përcjellë nga shkolla e Magjistraturës, për vitin qershor 2019 dhe qershor 2020 ka rezultuar se:

i) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4070.31 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 91.46 % të pikëve totale.

ii) kandidati z. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4073 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 91.52 %, të pikëve totale.

iii) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4129.37 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 92.79 %, të pikëve totale.

iv) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 2990 pikë, nga 3200 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 93.44 %, të pikëve totale.

Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, sipas listës së klasifikimit të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 258, datë 24.05.2023, ku më lart renditet kandidatja znj. {...}, ndërsa kandidatët tjetër znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...} renditen pas saj.

Siç u argumentua më sipër, nuk ekziston pengesë ligjore për të kryer renditjen e kandidatëve të diplomuar në vite të ndryshme akademike, pasi renditja bazohet në vlerësimet e marra nga kandidatët e diplomuar në raport me pikët e mundshme. Zonja {...} është vlerësuar me 93.44 % të pikëve të mundshme, znj. {...} është vlerësuar me

92.79 %, të pikëve të mundshme, z. {...} është vlerësuar me 91.52 %, të pikëve të mundshme dhe znj. {...} është vlerësuar me 91.46 %, të pikëve të mundshme. Për pasojë, renditja e kandidatëve për këtë pozicion është si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}; 3) Z. {...}; 4) Znj. {...}.

Bazuar në sa përcaktohet në pikat 40-42, të këtij relacioni, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 43 të tij, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 258, 24.05.2023”.

Bashkëlidhur këtij relacioni janë dhe projektvendimet, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

Për pozicionin e hapur me vendimin nr. 256:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.256, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}; 3) Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, Znj {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

Për pozicionin e hapur me vendimin nr. 257, në dispozitiv ju sugjerohet të miratoni:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.257, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}; 3) Z. {...}; 4) Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

Për pozicionin e fundit 258, në dispozitivin e vendimit ju sugjerohet të miratoni:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.258, 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}; 3) Z. {...}; 4) Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve përkatës sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, të ndryshuar.

Me kaq përfundoj dhe relacionin.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Atëherë kalojmë në votim të projekt-aktit.

Po!

Gentiana Muçaj: Unë dua të di se si është bërë llogaritja e pikëve, metodologjia se si kanë dalë këto përqindje dhe si janë vendosur këto kandidatët në kushte të barabarta, kur tre kandidatë i kemi që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës 3–vjeçare dhe tjetra 2–vjeçare, si është llogaritur nga ana juaj kjo përqindja, metodologjia? Çfarë është marrë për bazë? Apo thjesht janë marrë për bazë këto pikët?

Alban Toro: E kemi thënë në këtë panel që nga ana jonë nuk ka diskrecion në vlerësim në rastin konkret sepse bëhet fotografimi i vlerësimit që ka bërë shkolla. Thjesht është bërë aplikimi...

Gentiana Muçaj: Jo të lutem, unë nuk po flas për diskrecion.

Jo, jo, që të jemi më konciz.

Alban Toro: Ta vijoj unë pastaj..

Pse nuk keni durim ta dëgjosh. Ta mbaroj unë njëherë, pastaj fol.

Gentiana Muçaj: Mirë, dakord.

Alban Toro: Unë po të thoja që në rastin konkret Këshillit i mungon diskrecioni (sepse do dalë tek diskutimi që kemi bërë e ribërë) dhe kemi fotografuar thjesht vlerësimet që ka bërë Shkolla dhe renditja është bazuar në vlerësimet e marra nga kandidatët e diplomuar në raport me pikët që ata kanë. Kjo është.

Gentiana Muçaj: Si ka dalë kjo 91.52 % i {...}?

Alban Toro: Po i ka nxjerrë shkolla.

Gentiana Muçaj: Unë nuk kam asnjë material si i ka nxjerrë shkolla.

Alban Toro: Atëherë, materialin e keni pasur në dispozicion nga momenti që është bërë relatori...

Gentiana Muçaj: Mua më duket nonsens që një që ka 4073 pikë, nga 4450 të mundshme (po marrë {...}), të renditet më pas njërit që ka 2990 pikë, nga 3200 të mundshme. Domethënë si i keni vendosur ju këta në kushte të barabarta, se kandidatët duhet të jenë në kushte të barabarta.

Jo shkolla jo, ne. Si janë vendosur, se një është me dy vite shkollë dhe një është me tre vite shkollë. Në rast se unë në tre vite shkollë kam dhënë 40 provime dhe kam marrë 4000 pikë, tjetra ka dhënë 30 provime (30 lëndë) dhe del në përqindje më shumë. Domethënë si është vendosur barazia ndërmjet kandidatëve?

Alban Toro: Genta njëqind herë. Ne thjesht po të sjellë, që kam marrë fotografimin që ka bërë vlerësimin shkolla. Më fal Genta, sot shkolla bën me 6500 pikë. Çfarë diskutimi tjetër do bëjmë? Prapë kush do të jetë emëruesi i përbashkët? Ligji të thotë, do marrësh renditjet sipas...

(Zonja Muçaj flet pa ndezur mikrofonin.)

Alban Toro: E ka bërë shkolla. S'i hyj unë asaj pjesës.

(Zonja Muçaj flet pa ndezur mikrofonin.)

Alban Toro: Genta, për sa kohë këta kandidatë bëjnë pjesë tek lista e kandidatëve që nuk mund t'u bëhet vlerësim, je i detyruar të marrësh atë të shkollës.

(Zonja Muçaj flet pa ndezur mikrofonin.)

Alban Toro: Për mua janë në kushte të barabarta, se s'e kam bërë unë vlerësimin.

(Zonja Muçaj flet pa ndezur mikrofonin.)

Alban Toro: Atëherë, hajde ta ndryshojmë aktin nënligjor.

Po propozoj ndryshimin.

Unë nuk di me pak, me shumë, me të mesëm, me të lartë.

Unë di si është fotografimi i rastit.

Më fal, në rastin konkret shkolla do dali me 6500 pikë. Çfarë do më thuash?

Gentiana Muçaj: Dhe unë i qëndroj prapë mendimit që për tre kandidatët {...}n, {...}n dhe {...}n duhet bërë vlerësim profesional, vlerësim profesional për aq kohë sa vetë Këshilli ka vendosur në program vlerësimin e 2024 dhe duke njohur të plotë 2020. Këto kisha. Dhe unë nuk mora përgjigje sepse janë këta në kushte të barabarta.

Klodian Kurushi: Më fal, mund ta sqaroj këtë pjesën.

Naureda Llagami: Ishim në procedurë votimi.

Po, vazhdojmë tani.

Klodian Kurushi: Shkurtimisht.

Shkolla e Magjistraturës funksionon, po themi, me tre forume: këshilli drejtues, drejtori i shkollës dhe këshilli pedagogjik. Këshilli pedagogjik është një organ i Shkollës së Magjistraturës që merr vendime për kurikulat (ripërsëritet fjalía). Për shembull në një vit, thotë ajo, ne t'i bashkojmë procedurën penale me të drejtën penale (që po e bëjnë këtë vit) dhe në një vit tjetër mund të thotë: "Shiko, ne i ndajmë këto dy lëndët dhe bëjmë veç penalen dhe veç procedurën, ndajmë kurikulat, ndajmë edhe pikët.". Por programi është ai program.

Në këtë pikë ndodh dhe do ndodhemi në situata që një vit nga një vit tjetër mund të mos kenë të njëjtat kurikula dhe të njëjtët pikë magjistratët kur diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës. Pse? Sepse ndahen lëndët, shtohen lëndët. Ia ka dhënë ligji si diskrecion shkollës që të vendosi dhe t'i miratojë vetë kurikulat. Ajo çfarë në fund fare të gjithë brezat barazohen është fakti që ata marrin diplomën e magjistratit dhe kur vijnë këtu përpara nesh, janë të gatshëm të diplomohen nga shkolla, bëhet kualifikimi i tyre dhe caktohen në pozicion. Caktimi në pozicion i tyre bëhet mbi bazën e vlerësimit që na e jep shkolla. Në vlerësimet që jep shkolla për çdo vit, është në një rubrikë “numri i pikëve për lëndë” dhe “përqindja në total” (sa për qind merr njëri kandidat në raport me kandidatin tjetër, për të bërë krahasimin). E ka bërë shkolla edhe përqindjen, nuk e bëjmë ne. Pra numri total i pikëve me numrin që ai ka marrë. Dhe aty bën renditjen ai: njëri merr 98%, njëri 97, njëri 95, 94, e kështu vijon renditja. Kjo është pjesa që e bën shkolla dhe kam përshtypjen në relacion zoti Toro nuk ka bërë (jo kam përshtypjen, kjo është e vërtetë), nuk ka bërë përqindjen e pikëve që ka marrë njëri kandidat nga kandidati tjetër, ka marrë vetëm listën përfundimtare të vlerësimit për të gjithë kandidatët, për një vit dhe për një vit tjetër. Kushtet e barabarta lidhen me situatën kur kandidatët kandidojnë me vlerësimin e Shkollës së Magjistraturës, ata vihen në kushte të barabarta. Shkolla e Magjistraturës bën vlerësimin e një personi, bën vlerësimin e një personi tjetër. Dy personat mund të jenë breza të ndryshëm. Por Këshilli në këtë rast nuk bën dot vlerësim... sepse po, janë të dy të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe në këtë pikë ne marrim vetëm listat e Shkollës së Magjistraturës dhe këta janë në kushte të barabarta. Ligji nuk thotë në asnjë rast që këta duhet të kandidojnë vetëm brenda brezit të tyre. Apo jo? Po pra, dhe kushtet e barabarta lidhen me faktin që ne nuk i bëjmë dot vlerësim atyre dhe vlerësimin ne e marrim nga lista e Shkollës së Magjistraturës, për ata që ne nuk i bëjmë dot vlerësim.

Emona Muçi: Unë kam një kërkesë.

Se çudi, do ishte shumë çudi, në qoftë se do merrej një jomagjistrat dhe një magjistrat për ta futur në këtë procedurë, që thamë që vetëm magjistratët, domethënë ata i ka diplomuar shkolla dhe janë të dy magjistratë dhe tashmë u vendosën në pikë të barabartë. Domethënë i binte që të ishte një jomagjistrat dhe një magjistrat, që s'ndodh.

Klodian Kurushi: Si një magjistrat..?

Emona Muçi: Nejse, vazhdova batutën.

E di si është puna? Unë kam shumë dëshirë dhe kam shumë nevojë, për të marrë një vendimmarrje, unë duhet të shoh njëherë lëndët, domethënë numrin e lëndëve që ka pasur një brez me brezin tjetër, për shkak se, nuk jam shumë e bindur për këtë që po them por, mund të jetë brezi i vetëm që programi është ndryshe nga programet e pranimit që ka Shkolla e Magjistraturës. Pikërisht tek ky rast më duhet të kem shumë mirë parasysh, të themi, meritokracinë në ato lëndët që kanë bërë secili dhe të krijoj një ide. Domethënë, është e vërtetë kjo që thotë shkolla që është e tillë apo mund të kem ndonjë arsytim tjetër. Për këtë arsye më nevojitet kjo.

Alban Toro: Më fal, ose s'kuptojnë ose bëjnë sikur s'kuptojnë, ose s'kanë lexuar asgjë. Atëherë, referuar akteve nënligjore që ke, aty do të gjesh të gjithë zgjidhjet që do të kërkohet.

Ne, ju thashë, kemi bërë vetëm fotografim të vlerësimit të gjësë që ka bërë shkolla. Absolutisht asgjë. Tani do t'juja sjell, meqenëse nuk keni pas kohë ta lexoni. Përqindjen, çfarë ka bërë shkolla, e ka bërë shkolla, jo unë. Prandaj ju thashë mungon diskrecioni nga ana e ime. Unë vendos matematikën e shkollës. Nëse dikush thotë ma ka bërë shkolla gabim, le ta reklamojë.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Alban Toro: Ma thotë ligji. Në kushte krejtësisht të barabarta, sepse ashtu i ka bërë shkolla, sepse në të tillë janë vlerësuar.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Alban Toro: Genta, kur flasim, më gjej bazën ligjore moj Genta!

Naureda Llagami: Alban, të lutem për sqarim, mund të referosh rregulloren tonë të transferimit dhe pikët që ne bëjmë.

Sqaroje pak të lutem!

Po pra, meqë të sollën dokumentacionin, për efekt kohe.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Në fakt ne kur diskutojmë për kohën e themi që në fillim të projekt-aktit. Ne e kemi këtë praktikë. Pra nëse neve nuk jemi të përgatitur, ne nuk hyjmë në relativim. Në momentin që ne hyjmë në relativimin e projekt-aktit dhe ju pranuat zonjë që të ishit në relativim të projekt-aktit, do të thotë që ke dijeni për projekt-aktin. Nëse i bërë pyetje relatorit, relatori po të jep përgjigje.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Patjetër, edhe kohën.

Po të të japi argumentin njëherë relatori dhe më pas vlerësojmë kohën për ty. Nuk mundesh ti në mes të aktit të thuash unë dua kohë, dua 5 minuta. Nuk funksionon si në gjykatë këtu. Këtu jemi organ administrativ. Këtu kur futemi, kemi kohën e mjaftueshme 7 ditë për të gjykuar dhe nuk kemi fakte dhe prova të reja këtu. Këtu ne hyjmë dhe mbarojmë punë me shqyrtimin e çështjeve. Në gjykatë po. Ke të drejtë zonjë, në gjykatë ashtu i keni. Këtu jo.

Kështu që hajde e ndryshojmë procedurën.

Alban të lutem, fol me...

Emona Muçi: Atëherë, nevoja ime...

Naureda Llagami: E ka fjalën zoti Toro.

Emona Muçi: Një sekondë.

Paraprkisht, tani sapo mu tha që unë e kisha të nevojshme... domethënë në qoftë se unë pranova që të hyja në këtë relativim dhe nuk kisha bërë ndonjë pretendim në

lidhje me njohjen apo mosnjohjen, e kam thënë paraprakisht, para se neve këtu të kishim vijuar me këtë relativitetin, unë kam thënë: Një shkak që mund të jetë për pjesën e shtyrjes së këtij relacioni ka qenë njohja me listat se e kam të nevojshme. Asnjëri prej jush nuk e tha. Unë tani po e përsëris.

Naureda Llagami: Nuk e ngrite fare këtë gjë.

Megjithatë zoti Toro të lutem, shkurtimisht.

Alban Toro: Të sqaroj çështjen e akteve. Aktet kanë qenë në dosjen për të cilin relatori ka disponuar. Kush ka dashur, ka pasur dëshirë, mund t'i tërhiqte në çdo moment. Në qoftë se ka neglizhencë dhe nuk gjejnë kohën për të studiuar dosjet, është çështje e tyre.

Tani, po sjell në vëmendjen tuaj një format të vlerësimit që ka bërë Shkolla e Magjistraturës për vitin akademik 2018-2019. Do i kërkoj ndjesë kandidatëve që do i përmend emrin, por jam i detyruar. Për znj. {...} 95.43 është vlerësimi në përqindje, vlerësimi në nivel është "Shumë mirë". Për z. {...}, vlerësimi në pikë është 4209.15, vlerësimi është "Shumë mirë", 94.58%. Për znj. {...}, vlerësimi është 4170.82, 93.72%, "Shumë mirë". Pra kështu kanë vijuar të gjithë, nga zoti {...}, {...}, {...}, {...}, etj. Ky është fotografimi që kam bërë. Renditja është pasojë e kësaj fotografie.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ndonjë tjetër?

Atëherë, kemi ndonjë diskutim tjetër?

Lidhur me qëndrimin e pjesës se si ju e vlerësoni, kjo është gjë tjetër.

Proceduralisht, për pjesën që ju kërkuat informacion, relatori jua vuri në dispozicion?

Emona Muçi: Unë kërkoja momentalisht, se nuk kam kërkuar përqindjen, se përqindjen e gjej dhe vetë, kam kërkuar lëndët specifike, si janë formuar ato pikë. Kaq kërkoja unë. S'mu dha. U menduat që mos të ma jepnit këtë... Si të doni.

Alban Toro: Nuk jemi në këshill pedagogjik këtu që të japim edhe lëndët. Ik kërkoje tek Shkolla e Magjistraturës. Ke vlerësimet aty.

Duhet të dijë edhe çfarë banke kanë qenë ata në momentin që janë diplomuar.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Edhe një herë të lutem! Ruani etikën!

Edhe një herë, lidhur me vlerësimin final të Shkollës së Magjistraturës e cila është pjesë edhe e referimit nga ana e rregullores sonë.

Është vënë në dispozicion nga relatori. I pamë të gjitha që kemi vlerësimin final.

Lidhur me interpretimin çfarë konsiderohet vlerësim final, kjo është çështje diskrecioni i gjithsecilit prej anëtarëve. Ta mendojnë dhe ta vlerësojnë si duan. Ajo që ne po diskutojmë këtu është që çfarë ka konsideruar edhe akti nënligjor, që është rregullorja e transferimit, edhe praktika e Këshillit si vlerësim final, dhe vendosja në kushte të barabarta ka qenë vendosja e vlerësimit final dhe personave që titullohen magjistratë. Tashmë pjesën e interpretimit, kjo është diskrecion që secili prej jush mund të ketë hapësirën dhe interpretimin e vet, dhe kjo është pjesë e rishikimit aktualisht, që mund të keni edhe propozim për ta rishikuar rregulloren, në qoftë se ju doni të kapërceni edhe atë që ndoshta edhe ligji e ka taksative. Kjo është pjesë diskrecioni që neve mund ta vlerësojmë. Në këto momente që jemi dhe mënyrën se si Këshilli ka aplikuar rregulloren, kjo është situata faktike që ka Këshilli në zbatim të ligjit, rregullores dhe të informacionit që na vjen nga Shkolla e Magjistraturës.

Kështu që, nëse kemi mbaruar sqarimet mbi këtë çështje, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Unë jam dakord për miratimin në lidhje me kandidatin {...}, ndërsa për kandidatët e tjerë jam kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Unë jam kundër, pasi nga ana e Këshillit iu kërkoja që të më vendosnin në dispozicion një sërë materialesh me të cilat unë të mund të vendosja. Në momentin që unë nuk kam asnjë informacion për atë, ashtu sikurse unë e vlerësoj dhe kam diskrecionin për të vendosur në lidhje me meritokracinë e transparencës si dhe me pikëzimin e lëndëve speciale për këtë rast, që është një rast specifik, unë vendos kundër, pasi e kam të pamundur për të vendosur në mënyrë tjetër në këto kushte.

Klodian Kurushi: Unë jam dakord me propozimin e bërë nga kolegu ynë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr.256, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...};
- 3) Z. {...}.
2. Kopje e arsyetuar i njoftohet kandidatëve [...].

Naureda Llagami: Kalojmë. Hedhim në votim propozimin e dytë mbi renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në të njëjtën gjykatë, që është hapur me vendim të Këshillit nr. 257, ku propozohet renditja sikurse e relatoi relatori. Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Unë jam kundra për {...}, {...} dhe pro {...}.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Kundër, me të njëjtin arsyetim.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, këshilli vendosi:

Renditjen e kandidatëve për këtë pozicion, si më poshtë:

1) Znj. {...};

2) Znj. {...};

3) Z. {...};

4) Znj. {...}.

Gjithashtu kopje e arsytuar e vendimit i njoftohet të gjithë kandidatëve.

Naureda Llagami: Kalojmë tek pozicioni i tretë që është hapur me vendimin e Këshillit 258, datë 24.05.2023, sipas relatimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Unë njësoj jam me votimin, pro {...}t, kundër {...}t edhe {...}.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Kundër, me të njëjtin arsyetim.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, këshilli vendosi:

Renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.258, datë 24.05.2023, sipas renditjes:

1) Znj. {...};

2) Znj. {...};

3) Z. {...};

4) Znj. {...}.

Kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve respektivë.

Me kaq, po e mbyllim seancën.

Ndjesë, po bëjmë 5 minuta pushim, për t'u rikthyer për shqyrtimin e tre çështjeve të tjera.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë, Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242 dhe 243, datë 02.05.2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator znj. Emona Muçi).⁵

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.⁶

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 14:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 3 sipas rendit të ditës.

⁶ Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi, pas largimit të Kryetares, pas trajtimit të çështjes nr. 6.

5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Markelian Koça* (anëtar)
8. *Yllka Rupa* (anëtare)
9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijim e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 6.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja e këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë, Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242 dhe 243, datë 02.05.2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator *znj. Emona Muçi*).

Ilir Rusi: Në vijim mbledhja do të drejtohet nga unë Zëvendëskryetar Ilir Rusi, për shkak se Kryetarja kishte një angazhim institucional.

Në vijim të këtij rendi dite, vazhdojmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë, Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242 dhe 243, datë 02.05.2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores znj. Muçi.

Emona Muçi: Faleminderit!

Në lidhje me pikën për të cilën do relatoj, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240 dhe 241, datë 02.05.2024 ka hapur 9 (nëntë) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë dhe Fier, për 7 (shtatë) pozicione të lira të përhershëm në fushën e së drejtës civile dhe 2 (dy) pozicione të lira në fushën e së drejtës penale. Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 242 dhe 243, datë 02.05.2024 ka hapur 2 (dy) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për 2 (dy) pozicione të lira të përhershme.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për secilin nga pozicionet e mësipërme, bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, rezulton të kenë kandiduar gjyqtarët sipas tabelave, pjesë të këtij relacioni që janë bërë të njohura të gjithë anëtarëve të këshillit.

Në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore, faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, për çdo pozicion të lirë të shpallur, fillon për gjyqtarët kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike profesionale. Në rast se për pozicion konkret nuk ka kandidatë të tillë, ata janë tërhequr nga kandidimi ose janë skualifikuar për

mosplotësim kushtesh, procedura e lëvizjes paralele vijon për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim, e në mungesë edhe të këtyre të fundit, vijon me kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim. Për të bërë të mundur në veçanti gjyqtarët që “mund të kenë 2 vlerësime, 1 vlerësim, ose nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, në pikën 9 të çdo vendimi hapje procedure lëvizje paralele, Këshilli ka parashikuar se: “Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”.

Bazuar sa më sipër, Komisioni pasi verifikoi përvojën profesionale të secilit nga gjyqtarët kandidatë si më sipër dhe ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për secilin prej tyre, sipas Skemës së Re të Vlerësimit të Gjyqtarëve, vlerësime të mbaruara, atyre në proces të filluara ose që mund të fillonin sipas programit të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, si dhe bazuar në detyrimin e parashikuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.263, datë 21.11.2019, për fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për gjyqtarët që kanë aplikuar në rastin konkret për lëvizje paralele, vlerëson se:

Mundësia e pasjes së dy apo të një vlerësimi, evidentohet referuar programeve të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, pjesë e të cilëve janë: gradimet, vlerësimet periodike 3-vjeçare, si dhe vlerësimet e përshpejtuara në rastet kur gjyqtarët kandidojnë për lëvizje paralele. Hapja e procedurave për lëvizje paralele nuk nënkupton dhe as kërkon sipas ligjit miratimin e programeve të posaçme të vlerësimit për të gjithë gjyqtarët kandidatë;

Referuar neneve 43, 84 dhe 171 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit të KLGJ nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjeve paralele”, për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që gjatë kësaj periudhe kanë më shumë se 1 vit punë si gjyqtar (duke përjashtuar stazhin profesional të kryer në kuadër të Shkollës së Magjistraturës), vlerësim i parë konsiderohet ai i gradimit.

Për këta gjyqtarë, për efekt të pasjes së dy vlerësimeve, vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2023, si vlerësim i dytë për efekt të procedurës së lëvizjes

paralele, do të fillojë vetëm nëse ata nuk janë përfshirë në programet e vlerësimit periodik të miratuara nga Këshilli (vlerësimi 3-vjeçar 2017-2019, 2020-2022, 2021-2023 ose vlerësim i përshpejtuar vitit kalendarik 2022).

Për gjyqtarët që e kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që gjatë kësaj periudhe kanë më pak se 1 vit pune si gjyqtar (duke përjashtuar stazhin profesional të kryer në kuadër të Shkollës së Magjistraturës), vlerësim i parë konsiderohet ai periodik 3-vjeçar i filluar ose që mund të fillojë, sipas programeve të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli. Për këta gjyqtarë vlerësimi i dytë do të konsiderohet ai i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2023. Por ky i fundit do të konsiderohet i mundshëm për t'u kryer vetëm në rastin kur kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga vlerësimi i fundit, në këtë rast nga viti 2019, apo viti 2020.

Për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, por që nuk janë përfshirë në programin e vlerësimeve të miratuar nga Këshilli, gradimi nuk mund të realizohet, prandaj për këta gjyqtarë vlerësim i parë do të konsiderohet vlerësimi i fundit etik dhe profesional që ka qenë në fuqi përpara Ligjit për Statusin. Për këta gjyqtarë vlerësim i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2023.

Për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional sipas rregullave që kanë qenë në fuqi përpara Ligjit për Statusin, por që janë përfshirë në programin e vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, gradimi nuk mund të realizohet, prandaj vlerësimi parë do të konsiderohet ai periodik, sipas programit të vlerësimeve për vitin 2021, që i përket periudhës së vlerësimit 2017-2019. Për këta gjyqtarë vlerësimi i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2023, vlerësim që Këshilli ka marrë përsipër të kryejë në rastet kur kandidohet për lëvizje paralele. Por ky i fundit do të konsiderohet i mundshëm për t'u kryer vetëm në rastin kur kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga vlerësimi i fundit, në këtë rast nga viti 2019 apo 2020.

Për gjyqtarët e emëruar nga KLGJ, për të cilët verifikimi i pasurisë e figurës është bërë prej tij, vlerësim i parë etik-profesional i mundshëm për t'u kryer, do të konsiderohet ai i parashikuar në programin e vlerësimit për vitin 2023 dhe 2024 të miratuar nga Këshilli.

Bazuar në kriteret e mësipërme, lidhur me vlerësimet e kryera e mundësinë e kryerjes së tyre sipas Skemës së Re të Vlerësimit të Gjyqtarëve, për secilin gjyqtar në veçanti, konkludohet si më poshtë:

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i emëruar në datën. 20.11.2015, referuar informacionit të marrë nga dosja personale e gjyqtarit, rezulton se me vendimin nr. 397, datë 23.09.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur përfundimi i procedurës së vlerësimit për periudhën 2013-2016 (gradimit) për shkak se koha e ushtrimit të detyrës, brenda periudhës së vlerësimit, ishte më e shkurtër se një vit. Me vendimin nr. 376, datë 13.07.2023, Këshilli ka miratuar raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit për periudhën e vlerësimit 2017-2019 (vlerësimi i parë) dhe me vendimin nr. 432, datë 18.07.2023 Këshilli ka miratuar vlerësimin etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit viti 2022 (vlerësimi i dytë).

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i emëruar gjyqtar në datën 21.10.2013, gradimi si vlerësim i parë nuk mund të realizohet, në kushtet kur vendimi i KPK nr. {...}, datë 03.12.2021, për konfirmimin e tij në detyrë është ankimuar nga Komisioneri Publik në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, e si i tillë nuk ka marrë formë të prerë. Ky gjyqtar është përfshirë në programin e vlerësimit 3-vjeçar 2017-2019 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit për periudhën 2017-2019, që do të konsiderohet edhe vlerësim i parë për efekt të lëvizjes paralele. Për këtë gjyqtar mund të fillojë vlerësim i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2023, sepse ai ka punuar përgjatë këtij viti nga 1 janari 2023 deri në 31.01.2023, si gjyqtar i Skemës së Delegimit dhe prej datës 01.02.2023 si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër. Prandaj për këtë gjyqtar mund të ketë 2 (dy) vlerësime etik-profesional, sipas Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, e emëruar gjyqtare në datën 07.01.2009, mund të ketë dy vlerësime etike – profesionale. Vlerësimi i parë është ai i gradimit, në kushtet gjyqtarja ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, proces i cili ka filluar nga Këshilli

me vendimin nr.162, datë 03.04.2024, pas dërgimit të dosjes nga organet e rivlerësimi. Gjithashtu, gjyqtarja është përfshirë në programin e vlerësimit të miratuar për vitin 2024 për periudhën e vlerësimit periodik 3-vjeçar 2017-2019, për të cilën mund të fillojë vlerësimi, i cili do të konsiderohet vlerësimi i dytë për efekt të lëvizjes paralele.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, i emëruar gjyqtar në datën 27.09.2010, gradimi si vlerësim i parë nuk mund të realizohet, në kushtet kur vendimi i KPK nr. {...}, datë 08.03.2023, për konfirmimin e tij në detyrë është ankimuar nga Komisioneri Publik në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, e si i tillë nuk ka marrë formë të prerë. Ky gjyqtar është përfshirë në programin e vlerësimit 3-vjeçar 2017-2019 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit për periudhën 2017-2019, që do të konsiderohet edhe vlerësim i parë për efekt të lëvizjes paralele. Për këtë gjyqtar mund të fillojë vlerësim i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2023, sepse ai ka punuar përgjatë këtij viti nga data 1 janari 2023 deri në 31.01.2023, si gjyqtar i Skemës së Delegimit dhe prej datës 01.02.2023 si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Prandaj për këtë gjyqtar mund të ketë 2 (dy) vlerësime etik-profesional, sipas Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mund të ketë vetëm një vlerësim etik profesional, pasi gjyqtari ka 3 vjet përvojë profesionale.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, i emëruar gjyqtar në datën 20.10.2020, mund të ketë vetëm një vlerësim etik profesional, pasi gjyqtari ka 3 vjet përvojë profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, e emëruar në datën 20.10.2020, aktualisht e komanduar në Gjykatën e Lartë, mund të ketë vetëm një vlerësim etik-profesional, pasi gjyqtarja ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar në vitin 2023.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, e emëruar në datën 20.10.2020, aktualisht e komanduar në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, mund të ketë vetëm një vlerësim etik-profesional, pasi gjyqtarja ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2023.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, i emëruar në datën 20.10.2020, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi gjyqtari ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar në vitin 2023.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, e emëruar në datën 09.01.2020, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi gjyqtarja ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2023.

Për gjyqtarin Enkel Peza, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, i emëruar në datën 20.10.2020, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi gjyqtari ka 3 vjet përvojë profesionale.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Korçë (më falni), i emëruar gjyqtar në datën 19.07.2019, mund të ketë vetëm një vlerësim etik profesional, pasi gjyqtari ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2022.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, i emëruar në datën 09.01.2020, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi gjyqtari ka 3 vjet përvojë profesionale.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, aktualisht i komanduar në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi gjyqtari ka 3 vjet përvojë profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, e emëruar në datën 09.01.2020, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi gjyqtarja ka 3 vjet përvojë profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi ka 3 vjet përvojë profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi ka 3 vjet përvojë profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, e emëruar gjyqtare në datën 20.10.2020, aktualisht komanduar në

Gjykatën e Lartë, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi gjyqtarja ka 3-vjet përvojë profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, e emëruar gjyqtare në datën 19.07.2019, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, e emëruar në 19.07.2019, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi gjyqtarja ka 3 vjet përvojë pune gjatë vitit 2022.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, i emëruar në datën 09.01.2020, mund të ketë vetëm një vlerësim etik profesional, pasi gjyqtari ka 3 vjet përvojë profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, emëruar gjyqtare në datën 31.10.2014, referuar informacionit të marrë nga dosja personale e gjyqtares, rezulton se me vendimin nr. 502, datë 28.09.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur mosfillimi i procedurës së vlerësimit për periudhën 2013-2016 (gradimit) për shkak se koha e ushtrimit të detyrës, brenda periudhës së vlerësimit, ishte më e shkurtër se një vit. Me vendimin nr. 439, datë 19.07.2023 Këshilli ka miratuar raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares për periudhën e vlerësimit 2017-2019, që do të konsiderohet edhe vlerësim i parë për efekt të lëvizjes paralele. Për këtë gjyqtare nuk mund të fillojë vlerësim i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2023 sepse ajo ka filluar lejen e barrë lindjes nga data 16.11.2022 dhe është kthyer në punë në datë 22.10.2023. Ajo ka punuar gjatë vitit 2023 vetëm 2 muaj e 9 ditë, pra më pak se 1 vit brenda vitit 2023, çka pamundëson kryerjen e vlerësimit të përshpejtuar për këtë vit. Prandaj për këtë gjyqtare mund të ketë 1 (një) vlerësim etik-profesional, sipas Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, i emëruar në datën 09.01.2020, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2023.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, i emëruar në datën 06.03.2023, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi ky gjyqtar nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, e emëruar në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare nuk ka plotësuar përvojën 3-vjeçare.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, i emëruar në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi ky gjyqtar nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, i emëruar në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi ky gjyqtar nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e emëruar në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, e emëruar në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, e emëruar në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, e emëruar në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, i emëruar në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi ky gjyqtar nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, i emëruar në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi ky gjyqtar nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, i emëruar në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi ky gjyqtar nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, e emëruar në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

Për sa më sipër, në pikën 1 të projektvendimit është parashikuar miratimi nga Këshilli i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë e Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242 dhe 243, datë 02.05.2024, sipas Shtojcës I bashkëngjitur këtij vendimi.

Paraprakisht nga ana e Komisionit bëhet një propozim në lidhje me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024 në të cilin Këshilli ka hapur procedurën e lëvizjes paralele për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe pas përfundimit të afatit të kandidimit për këtë pozicion, bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, rezultojnë të kenë kandiduar gjyqtarët {...}, {...}, {...}, lidhur me vlerësimet e kryera në mundësinë e kryerjes së tyre sipas Skemës së Re të Vlerësimit të Gjyqtarëve për tre kandidatët që kanë aplikuar për lëvizje paralele për këtë pozicion, rezultojnë se janë klasifikuar gjyqtarët {...}, si gjyqtare që mund të ketë një vlerësim. Ndërsa gjyqtarët {...} dhe {...} si gjyqtarë që nuk mund të kenë asnjë vlerësim, propozoj që në miratimin e këtij projektvendimi të shtohet edhe ky vendim nr. 260, datë 16.05.2024.

Përfundimisht Shtojca 1 bashkëlidhur këtij vendimi të jetë:

Lista e gjyqtarëve që kanë 2 (dy) vlerësime:

1. Zoti {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 2 (dy) vlerësime:

1. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

2. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

3. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Në pikën 2 të projektvendimit është parashikuar miratimi nga Këshilli i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë e Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e mësipërme.

Lista e gjyqtarëve që kanë 1 (një) vlerësim:

1. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim:

1. Z. {...},
2. Znj. {...},
3. Znj. {...},
4. Z. {...},
5. Znj. {...},
6. Z. {...},
7. Z. {...},
8. Z. {...},
9. Z. {...},
10. Znj. {...},
11. Znj. {...},
12. Znj. {...},
13. Znj. {...},
14. Znj. {...},
15. Znj. {...},
16. Z. {...},
17. Znj. {...},
18. Z. {...}.

Në pikën 3 të projektvendimit është parashikuar miratimi nga ana e Këshillit, gjendet lista e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë e Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të analizuara në këtë relacion.

Lista e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim përbëhet nga:

1. Z. {...},
2. Znj. {...},
3. Z. {...},
4. Z. {...},
5. Znj. {...},
6. Znj. {...},
7. Znj. {...},
8. Znj. {...},
9. Z. {...},
10. Z. {...},
11. Z. {...},
12. Znj. {...}.

Propozoj që në projektvendim të përcaktohet edhe hyrja e tij në fuqi.

Pra propozimi ishte që relacioni të përfshijë në miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë 2 vlerësime, 1 vlerësim si dhe gjyqtarët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë, Fier dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242 dhe 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçi!

Keni diskutime për sa u parashtrua nga zonja Muçi, duke marrë në konsideratë

edhe përditësimin e relacionit dhe shtimin e tij përgjatë relatimit duke përfshirë edhe një publikim që kemi bërë neve në lidhje me transferimin?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Ju bëj me dije që zonja Plaku nuk është prezent në vijim të kësaj mbledhjeje.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë, Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242 dhe 243, datë 02.05.2024, dhe nr. 260, datë 16.05.2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë e Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242 dhe 243, datë 02.05.2024, dhe nr. 260, datë 16.05.2024, sipas Shtojcës I bashkëngjitur këtij vendimi.

Shtojca I është me këtë përmbajtje:

Lista e gjyqtarëve që kanë 2 (dy) vlerësime:

1. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 2 (dy) vlerësime:

1. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë (transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë).

2. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.

3. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

2. Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë e Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242 dhe 243, datë 02.05.2024, dhe nr. 260, datë 16.05.2024, sipas Shtojcës II bashkëngjitur këtij vendimi.

Përmbajtja e Shtojcës II është si më poshtë:

Lista e gjyqtarëve që kanë 1 (një) vlerësim:

1. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim:

1. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

2. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (komanduar në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë).

3. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (aktualisht komanduar në pozicionin “Këshilltar” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë).

4. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

5. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje

6. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

7. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

8. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

9. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (komanduar në pozicionin e “këshilltar juridik”, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut).

10. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

11. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

12. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

13. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (komanduar në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë).

14. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë (transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës).

15. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë (transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës).

16. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë (transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës).

17. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

18. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

3. Miratimin e listës së gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë e Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242 dhe 243, datë 02.05.2024, dhe nr. 260, datë 16.05.2024, sipas Shtojcës III bashkëngjitur këtij vendimi.

Shtojca III ka këtë përmbajtje:

Lista e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim:

1. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
2. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
3. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.
4. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
5. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
6. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.
7. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
8. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.
9. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
10. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
11. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
12. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë/ dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.⁷

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 14:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

⁷ Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi, pas largimit të Kryetares, pas trajtimit të çështjes nr. 6.

7. *Markelian Koça* (anëtar)
8. *Yllka Rupa* (anëtare)
9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijim e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 6.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja e këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë/ dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve

ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë/ dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Në mbledhjen plenare të datës 02.05.2024 dhe 16.05.2024, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor për mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242 dhe 243 datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës Tiranë, Fier dhe gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë.

Bazuar në parimet e parashikuara në nenin 42, të ligjit “Për Statusin”, ligjvënësi ka synuar që nëpërmjet rregullave kryesisht procedurale në nenin 43, të garantojë qartësi dhe parashikueshmëri për transferimin e magjistratit në procedurën e lëvizjes paralele, si një nga mjetet standarde të lëvizjes së gjyqtarëve brenda të të njëjtit nivel, pjesë e zhvillimit të karrierës së tij.

Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele siç u përmendën dhe më lart, u caktua deri më datë 16.05.2024 (vendimet nr. 233-243) dhe datë 30.05.2024 për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallën e Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, lëvizje e cila është shpallur me vendimin nr.260.

Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej 39 (tridhjetë e nëntë) kandidatura, të cilët kanë aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e lira fushën e së drejtës civile, penale dhe administrative. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë janë paraqitur 20 (njëzet) kandidatura; në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës 14 (katërmëdhjetë) kandidatura; në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Elbasan nga 1 (një) kandidaturë; në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë 7 (shtatë) kandidatura; në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Elbasan

95

është paraqitur më vonë, pra me hapjen që ne kemi bërë të vendimit me nr. 260, 16.05.2024, u hap edhe një vend tjetër dhe u paraqitën edhe tre kandidatura të tjera.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”. Në respektim të këtij rregulli, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallëve të para që unë i përmenda më lart, për pozicionet e shpallura në këto vendime.

Procedurat e lëvizjes paralele:

Në Kreun IV të vendimeve respektive nr. 233 - nr. 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024, Këshilli ndër të tjera, vendosi përcaktimin e procedurës përkatëse që do të ndiqet si më poshtë.

Janë fazat, nuk po i lexoj sepse ne i kemi shpallur me vendimet e mëparshme.

Më tej Këshilli me vendimin e sotëm të datës 05.06.2024, ndër të tjera vendosi edhe miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë, Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e përmendura më lart.

Shtojca që i bashkëngjitet, janë ato që u lexuan pak më parë nga kolegja zonja Muçi dhe që u miratuan bashkërisht nga ana jonë në këtë mbledhje, kështu që nuk po i përmend edhe një herë emrat e kandidatëve që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime.

E njëjta situatë lidhet edhe me kandidatët që kanë ose që mund të kenë një vlerësim dhe këto kandidatë paraqiten në relacionin që ne kemi përgatitur në shtojcën 2; dhe po e njëjta situatë është edhe me listën e kandidatëve që përfshihen, pra ata kandidatë, siç thamë, që kanë ose mund të kenë nga një vlerësim, dhe në këtë listë unë po perifrazoj vetëm pozicionet ku ata kanë kandiduar: Pozicioni nr. 234 ka kandiduar z. {...}, që është gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, pra janë kandidatë që vlerësohen me nga një vlerësim (që kanë ose që mund të kenë një vlerësim); në pozicionin nr. 235, z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër; në pozicionin nr. 236, z. {...}, gjyqtar i Gjykatës

96

së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë; në pozicionin nr. 237, është zonja {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë (transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës), z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë (transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës); Në pozicionin nr. 237 ka aplikuar edhe z. {...}, duke pasur në proces pozicionet nr. 86/2024, 235/2024 dhe 236/2024. Bazuar në parashikimet e nenit 43/5 të Ligjit për Statusin aplikimi i këtij kandidati për pozicionin nr. 237 nuk është i vlefshëm sepse kalon numrin tre të aplikimeve që parashikon neni 43 i ligjit “Për statusin”; në pozicionin nr. 238, kandidojnë kandidatët znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, {...}, znj. {...}, z. {...}, për pozicionin nr. 239 kandidojnë kandidatët zonja {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}; për pozicionin nr. 241, kandidon kandidatja me një vlerësim znj. {...} dhe për pozicionin nr. 260, që është pozicioni i hapur me vendimin e fundit të Këshillit, në rendin e vendimeve që kemi hapur, kandidon znj. {...}.

Në këto kushte, në përputhje me pikën 9 të vendimeve, nr. 233-243 datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 si dhe bazuar në vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” të Këshillit, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Fier, të shpallura me vendimet nr. 234 - 239, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim.

E njëjta situatë ndodhet edhe për disa kandidatë për disa pozicione të cilat nuk kanë dhe nuk mund të bëhet asnjë vlerësim referuar vendimit që sapo mori Këshilli, datë 05.06.2024, ndër të tjera është vendosur miratimi i listës së gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në pozicionet që ne i përmendëm më lart.

Kështu, vlen të theksohet se për këtë kategori kandidatësh ne përmendim pozicionin nr. 233 që i përket Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Këtu vërehet se ka në garë kandidatë që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim. Për rrjedhojë për këtë pozicion Këshilli duhet të vijojë me verifikimin për kandidatët pa vlerësim.

Më tej unë nuk po zgjatem për strukturën e vendimit sepse është ajo që ne e kemi të integruar në pjesën e relacionit por e kemi edhe të propozuar në projektvendimin përkatës. Është strukturë e projektvendimit e cila parashikon situatën, shorti që hidhet dhe kandidatët që marrin pjesë në garë, ato që janë me dy vlerësime për pozicionet përkatëse, ata që mbesin me një vlerësim për pozicionet e tjera përkatëse dhe për një pozicion që kandidon vetëm një kandidate e vetme, ajo mbetet një kandidate që nuk mund të ketë vlerësim.

Në hedhjen e shortit, për të përzgjedhur relatorin për kandidatët, ne si Komision, meqenëse gjithsej ata që kanë 2 vlerësime, ose mund t'u bëhen 2, ata që kanë 1 ose që mund t'u bëhet 1 dhe ata që nuk kanë dhe që nuk mund t'u bëhet asnjë vlerësim, gjithsej janë 23 kandidatë. Për këta 23 kandidatë ne si Komision propozojmë që secili prej anëtarëve të Komisionit të Përhershëm të Zhvillimit të Karrierës të caktohet relator për 8 kandidatë, ndërsa kryetari i Komisionit të caktohet relator për 7 kandidatë (gjithsej bëjnë 23 kandidatë). Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën në hedhjen e shortit sipas mekanizmit të propozuar nga relatori.

Procedura e shortit si vijon:

Në vazon e parë të qelqit hidhen me radhë goglat me shiritat e letrës me emrin e relatorit: z. Klodian Kurushi (relator për 7 kandidatë), z. Alban Toro (relator për 8 kandidatë), z. Markelian Koça (relator për 8 kandidatë).

Në vazon e dytë të qelqit hidhen me radhë goglat me shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj.

98

{...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i relatorit, z. Alban Toro. Zoti Toro do të jetë relator për 8 kandidatët e përzgjedhur nga shorti si vijon: 2.3 znj. {...}, 4.9 znj. {...}, 2.1 {...}, 2.2 z. {...}, 4.11 z. {...}, 4.12 z. {...}, 6.1 znj. {...} dhe 4.6 znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit, z. Klodian Kurushi. Zoti Kurushi do të jetë relator për 7 kandidatët e përzgjedhur nga shorti si vijon: 4.13 znj. {...}, 4.5 znj. {...}, 4.2 z. {...}, 4.7 znj. {...}, 4.14 z. {...}, 4.8 znj. {...} dhe 4.15 z. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit, z. Markelian Koça. Zoti Koça do të jetë relator për 8 kandidatët e përzgjedhur nga shorti si vijon: 4.16 znj. {...}, 4.1 z. {...}, 4.18 z. {...}, 4.17 znj. {...}, 4.4 z. {...}, 4.10 z. {...}, 4.3 znj. {...} dhe 2.4 z {...}.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj administratën të largohet.

Ka diskutime mbi projekt-aktin përditësuar edhe me të dhënat e shortit të sapo hedhur nga ana e administratës.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të

99

Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë/ dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 240, 242, dhe 243 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
2. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
3. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
4. Për kandidatin z {...}, relator z. Markelian Koça;

3. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Durrës, Tiranë, dhe Fier të shpallura me vendimet nr. 234, 235, 236, 237, 238, 239, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.

4. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...}, relator z. Markelian Koça;
2. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
3. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça;
4. Për kandidatin z. {...}, relator z. Markelian Koça;
5. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
6. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
7. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
8. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
9. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
10. Për kandidatin z. {...}, relator z. Markelian Koça;
11. Për kandidatin z. {...}, relator z Alban Toro;

12. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
13. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
14. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
15. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
16. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça;
17. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça;
18. Për kandidatin z. {...}, relator z. Markelian Koça;

5. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të shpallur me vendimin nr. 233, datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

6. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;

7. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.⁸

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 14:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

⁸ Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi, pas largimit të Kryetares, pas trajtimit të çështjes nr. 6.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijim e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 6.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja e këshillit të Lartë Gjyqësor **znj. Irena Plaku**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)**
- 5. Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën e fundit të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës paraqesim relacionin për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Rezulton se deri në datën 04.06.2024, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme: nr. i kërkesës 766, nr. i çështjes 31, nr. i gjyqtarëve që kërkohet të caktohen – 3. Në relacion parashtrohen edhe të gjitha pengesat e gjyqtarëve efektivë të kësaj gjykate.

Nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk mund të plotësohen përmes skemës së delegimit sipas nenit 45 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores së KLGJ-së “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, për shkak se në këtë skemë, nuk ka gjyqtarë që plotësojnë kushtet shtesë të sigurisë, siç kërkohet nga shkronja “b”, pika 4, e nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk mund të plotësohen as përmes transferimit të përkohshëm, me ose pa pëlqim, sipas nenit 46 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores së KLGJ-së “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, për shkak se një gjë e tillë ndalohet nga ligji. Konkretisht, në pikën 8, të nenit 42, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin”, përcaktohet se: “Një gjyqtar nuk lejohet të transferohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar”.

Në këto kushte, për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin X/2 të vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, por edhe referuar përcaktimeve të shkronjës “c”, pika 5, Kreu IV, të këtij vendimi, në zbatim të paragrafit VI, pika 4, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre që kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 3 (tre).

Në rast të pranimit të propozimit si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Për 1 (një) çështje penale, për të cilën kërkohen 3 (tre) gjyqtarë, të përzgjidhen me short 3 (tre) të tillë, ndërmjet gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart.

Bashkëlidhur është edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret.

Në lidhje me përjashtimet, referuar paragrafit VIII të vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, propozohet përjashtimi i znj. {...} zëvendëskryetarja e gjykatës dhe znj. {...} për shkak se ka pengesë ligjore për gjykimin e çështjes.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se një skemë e tillë e caktimit të gjyqtarëve për atë çështje gjyqësore të veçantë të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është mundësia më e mirë për përmbushjen e nevojave të kësaj të fundit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Nuk ka diskutime nga anëtarët.

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën në hedhjen e shortit.

Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën nr.766, gjyqtarët e përzgjedhur janë Brikena Ukperaj (relatore), Irena Brahimi dhe Diamela Goxha (anëtare).

Ilir Rusi: Faleminderit!

Me hedhjen e shortit edhe kjo pikë e këtij rendi dite u shqyrtua. Meqenëse ishte pika e fundit, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Pasdite të qetë.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor